

BIBLIOTEKA
SHËTETIT

814-32

T 91

Tregime

814-52

T-91


S

T R E G I M E

(Për fillestarë në

shkrim e

këndim)



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

- **A. LUARASI**
- **D. AGOLLI**
- **D. HASANI**
- **DH. XHUVANI**
- **I. SPASSE**

TREGIME

- **M. GJINI**
- **N. PRIFTI**
- **N. BARDHI**
- **P. MARKO**
- **XH. MATUKA**

Kultura jonë gjithmonë e më shumë po bëhet e masave, pronë e tyre e domosdoshme për aktivitetin e gjithanshëm në ndërtimin e socializmit në vendin tonë. Edhe admiruesit e letërsisë shtohen gjithmonë e më tepër. Kudo, në fabrikë, në uzinë, në arat e kooperativës, në stallat e saj, në repartet ushtarake, kufi etj. gjen lexues që presin me padurim romanin e ri, dramën e re, poemën, vjershën e re etj. ku gjejnë të pasqyruar jetën dhe ndjenjat e tyre.

Po takon edhe ndonjë njeri që të kënaqet me ato pak që ka mësuar nga përvoja e nga librat e parë. Për t'u ardhur në ndihmë këtyre, Shtëpia botuese «Naim Frashëri» boton këto tregime për fillestarë në shkrim e këndim.

GORICARËT

1.

Vjeshtë e vitit 1932.

Tre burra shtynë derën prej hekuri të gjykatës së diktimit në Tiranë dhe u gjendën në një oborr gjithë lule dhe pemë dekorative. Vështrimi i tyre ndoqi rrugën e shtruar me plloça të lëmuara, që bashkonte derën e jashtme me shkallët e gurta të ndërtesës dhe mbeti mbi trupin e një statuje prej mermeri të bardhë, që ngrihej gjithë dinjitet midis gjelbërimit. Drejtësia, e përfytyruar si një grua me sy të lidhur me shami, rrinte ditë e natë para gjykatës së diktimit, duke mbajtur në njerën dorë ballancën dhe në tjetrën një shpatë.

Një pamje me të vërtetë klasike!

Nën shtyllat e gurta në stil dorik, që mbanin ndërtesën si në pëllëmbë të dorës, çdo njeri ndjente pushtetin e padiskutueshëm të drejtësisë.

Tre katundarët tanë hynë gjithë drojtje në këtë ambient kaq të bukur e njëkohësisht kaq të huaj për ta. U printe një plak 60-70 vjeçar me flokë të thinjur e fytyrë eshtake. Pasi kaloi mes për mes oborrit, ai u mbështet në trungun e një palme dhe po thithte në heshtje tymin e duhanit nga llulla prej shqopeje që e kishte punuar vetë. Dy të tjerët, që ishin më të rinj, rrinin përballë tij dhe vështronin me kureshtje rrugën përtej kangjellave prej hekuri, ku kalonin gjithë zhurmë hamejtë dhe karrocacat.

Plakun nuk e tërhiqnin bukuritë e qytetit. Ai vështronte tokën që kishte nën këmbë dhe diç bluante me vete.

— Toka. . . — tha ai. — Sa gjak është derdhur për një pëllëmbë tokë! — Dhe para syve të plakut dilte beu, agai, qehajaj, gjykatësi, dilnin ata që i zhvatnin fukarasë sa më

tepër tokë. — Po — tha plaku. — Rrëmbe andej, rrëmbe këtej dhe fshati u zvogëlua e u mblodh në një pëllëmbë vend. — Në fillim u kishin marrë pyllin dhe pastaj kullotat. Dhe para syve të plakut u nder hapësira e bukur e fshatit. — Tani duan dhe tokën dhe shtëpinë, duan të na përzënë.

— More, a ka qeveri këtu, a ka drejtësi në botë? — tha me vete plaku duke vështruar truporen e drejtësisë.

— Po, ka! — ju bë sikur i foli statuja. — Pse, kot e mbaj unë në duar këtë ballancë dhe këtë shpatë? . . .

Plaku u përmend dhe i kaloi një buzëqeshje e lehtë dhe e hidhur ndër buzë, sepse ju kujtua gjyqi i Korçës.

Kishte qenë gjyq i madh ai dhe që zgjati shumë.

Vite me radhë Maliq Beu dhe larot e tij qehajallarët, vinin në fshat dhe kërcënonin: «O jepni të tretën, ose ju nxorëm nga fshati me gjithë leckë». Me ta u bashkuan edhe prefektura, edhe xhandarmeria, edhe gjykata. S'thonë kot: «Sorra sorrës s'ja nxjerr sytë».

Bëj hesap, edhe ligjet u ndryshuan sipas oreksit të bejlerëve.

Mirëpo goricarët nuk tundeshin.

Ata i kishin dhënë besën njëri-tjetrit se do të qëndronin gjer në fund. «Toka është e jona, kishin thënë goricarët, ne e kemi punuar denbabaden, prandaj Maliq beut nuk i japim as kaq!»

Kur e pa se me goricarët nuk i dillej, Maliq beu i hodhi në gjyq. Ishin shumë ata: njëqind e ca frymë si të paditur. Jashtë i priste i tërë fshati, burra, gra e kalamaj. Dy-tre avokatët e beut dukeshin si miza para gjithë atij fshati që nuk i nxinte salla. Dhe ishin të zemëruar. Burrat tundnin grushtet me urrejtje, gratë bërtisnin me të madhe, por nuk i dëgjoji njeri. Beu fitoi njërin gjyq pas tjetrit. U mori pyllin dhe kullotat në fillim, kurse, në gjyqin e fundit fitoi edhe tokat me shtëpitë e banimit, me një fjalë gjithë fshatin. Dikur i ati i Maliq beut i kishte vënë një sërë taksash fshatit. Tani i biri kërkonte t'u merrte tokat dhe shtëpitë.

Goricarët u zemëruan keq. S'i thonë

shaka! Kjo ishte luftë për tokën, luftë për bu-
kën, luftë për jetën. Kërkuan që ta ndiqnin
çështjen më lart. Mirëpo gjyqi do para. Shitën
bagëti dhe plaçka; gratë nxorën nga sënduku
stolitë e nusërisë, i shitën të gjitha, mblodhën
para dhe dërguan njerëz gjer në Stamboll për të
parë tapitë e tokave.

Por atje ata i përzunë, nuk u dhanë gjë.
Fshatarët vetëm një gjë dinin mirë, që Maliq
beu kësaj ane nuk kishte zotërime. Dhe ata
s'kishin dokument, por dhe beu s'kishte tapi.

Kështu pra, bënë kaq ditë rrugë dhe er-
dhën në Tiranë për të kërkuar drejtësi. Vinin
me shpresë se këtu ishte qeveri e madhe dhe
ndoshta do ta shihte çështjen më mirë, vinin
me shpresë se në Tiranë ndoshta Maliq beut
nuk do t'i shkonte fjala si në Korçë, ku kishte
fuqi dhe miq të shumtë.

— Ç'thua, xha Nini, sikur të kishim ma-
rrë një avokat, a nuk do të qe më mirë? . . —
pyeti njeri prej tyre.

Plaku nuk foli.

— Kot, a derëzi, sa të prishim paratë,
— u përgjegj në vend të tij bashkëbiseduesi

tjetër, një djalë i ri jo më tepër se njëzet e pesë vjeç, me faqe të kuqe e trupin si llastar. — Dihet se ne kemi të drejtë, po kush ta jep se! . . Puna jonë u duk që në Korçë, Vasil. A nuk e pe gjykatësin se si i mbante anën Maliq beut? Ti kujton se këta të Tiranës do të jenë më të mirë?

— Nejsë! — kundërshtoi Vasili. — Ne të bëjmë ç'kemi në dorë, pa të hollat do t'i mblidhte gjithë fshati pesë e pesë.

Boçoja nuk foli, por u duk se nuk ishte dakord me mendimin e shokut të vet. U tërhoq mënjanë dhe po vështronte oborrin me kureshtje.

Ishte me të vërtetë i bukur.

Mbi lulet vjeshtake shumëngjyrëshe, që harliseshin në të dy anët e oborrit, kishte plot pika uji. Ato sapo ishin vaditur. «Sa shumë tokë dhe vetëm për lule!» mendoi Boçoja tek shikonte ato lule të bukura që kishin çelur gonxhe gjithfarësh, të kuqe, të verdha, manushaqe. Mbi shkallët prej mermeri të bardhë të gjykatës së diktimit, mbi pllakat e bukura e të lëmuara, me gjithë ato kombinime të çuditsh-

me, që të merrnin mendjen kishin rënë gjethe të zverdhura, të thata e të fishkura. Kopshtari, që shërbente aty, u hodhi një vështrim indiferent atyre tre katundarëve, që prisnin sa të hapej gjyqi dhe shkoi më tutje me një fshesë në dorë.

Matanë kangjellave u ndal një veturë. Një burrë rreth të pesëdhjetave, veshur me kostum të errët dhe këmishë të bardhë, hyri hijerëndë në oborr. Kaloi afër goricarëve pa i vështruar me sy dhe ngjiti mengadalë shkallët e gjykatës së diktimit. Ai e dinte fort mirë ç'ishin ata të tre. Pas disa minutash do të ndeshej me ta si përfaqësues i Maliq beut, por... (avokat Konicës i qeshej!) ç'kundërshtarë mund të qenë ata tre copë katundarë që sigurisht, s'dinin të lidhnin dy fjalë para atij që kishte mbaruar fakultetin e drejtësisë dhe numëronte më tepër se pesëmbëdhjetë vjet praktikë në drejtësi? Pastaj, në këtë çështje, ai e kishte të fituar davanë me siguri sikur hiç të mos e hapte gojën: gjyqi kishte rëndësi politike. Luftonin përballë njëri-tjetrit beu dhe fshatarët e tij për çiflikun e Goricës. Në anën e

beut kishte ndërhyrë edhe qeveria. Vetë Musa Juka i kishte thënë personalisht: «Dëgjo, avokat Konica! Jepu një mësim të mirë atyre katundarëve rebelë, se për të tjerat do të kujdesem vetë. . .»

Kështu arësyetonte avokat Konica tek hynte në korridor, ndërsa goricarët e vështrojnë nga prapa.

Fill mbas tij, te shkallët, u duk ftuesi i gjykatës, një dibran i gjatë si vastarkë, që bërtiti me sa zë pati, megjithëse ata të tre ishin fare afër.

— Maliq bej Frashëri kundër goricarëve!

2.

Ja, erdhi çasti kur do të vendosej fati i tyre dhe i gjithë fshatit, që priste me ankth përfundimin e këtij gjyqi me rëndësi. Xha Nini nuk e humbi toruan. Duke ngjitur shkallët, ai diç bisedonte me Boçon.

Në sallën e gjykatës së diktimit tre goricarët e ndjenin veten si të huaj. Perdet e rën-

da prej damasku, parketi i lustruar me kujdes dhe gjithë ai ambient luksoz, që i rrethonte, u merrte frymën. Përballë tyre avokat Konica shfletonte me nge dekretin e ri: «Mbi padinat posedimore».

Në fillim foli një nga anëtarët e gjykatës. Me një zë të ngjirur e të pafuqishëm ai shpjegoi se gjykata e paqit në Korçë kishte vendosur detyrimin e katundarëve të Goricës të dorëzonin tokat e tyre në favor të Maliq bej Fra-shërit dhe të largoheshin përfundimisht nga fshati.

Pas tij, kryetari i kolegjit civil, një burrë shtatlartë e flokëthinjur, ju drejtua goricarëve:

— Po ju ç'keni për të thënë, përse ankoheni?

Në emër të goricarëve foli xha Nini. Kur u ngrit, vështroi një herë Vasilin që kishte nga e djathta, pastaj Boçon nga e majta dhe ju duk sikur pa të gjithë bashkëfshatarët e tij, gjashtëqind e ca frymë, burrat me vetulla të vrej-tura, gratë me fëmijë në krahë, të rinj e pleq, të gjithë ata që e kishin porositur të mbronte të drejtat e tyre para gjykatës së lartë. Kujtimi

i tyre bëri që të fliste më mirë, ashtu sikurse nuk kishte folur ndonjëherë:

— Zoti kryetar, zotërinj gjyqtarë! —
tha ai.

Kam nderin të flas në emër të 112 familjeve të katundit Goricë të prefekturës së Korçës, të cilët i ka hedhur në gjyq Maliq bej Frashëri. Ç'është e vërteta, do të na takonte ne e drejta për ta hedhur në gjyq këtë bej për shumë të këqija që ka punuar në kurrizin tonë, por nganjëherë punët ngjasin së prapi.

Shkurtimisht po ju tregoj, zotërinj gjyqtarë, se shtëpitë, tokat, vreshtat dhe pylli i Goricës na takojnë neve, goricarëve, se Maliq bej Frashëri vërtet është bej, dhe qoftë me shëndet, por Goricën nuk e ka pasur kurrë ndonjëherë çiflik të tij. Ai thotë se fshati ynë i është dhuruar një gjysh-stërgjyshi të tij prej sulltanit të Turqisë dhe kërkon që ta njohim për zot e t'i japim të tretën. Ky avaz nuk është i ri. E kemi dëgjuar shumë vjet përpara, qysh në kohë të Turqisë, por ne asnjëherë nuk e kemi njohur për bej. Në atë kohë na ka detyruar me forcë që t'i jepnim një pjesë të bereqetit,

dërgonte xhandarë turq dhe «trima» të tij, të cilët na e rrëmbenin nga lëmi apo nga hambari, kudo që ta gjenin. Ai ka punuar në kurrizin tonë shumë të këqija dhe s'na ka mbrojtur njeri, as prefektura, as xhandarmeria dhe as qeveria. Përkundrazi e kanë ndihmuar të na rrëmbente me forcë pyllin dhe kullotat, tashti kërkon të na marrë me gjyq edhe arat e shtëpitë që i kemi ngritur me duart tona. Për çudi gjykata e paqit në Korçë i dha të drejtë dhe na detyroi ne njëqind e ca familje, me gjashtëqind e ca frymë gjithsejt të ikim nga fshati dhe të lëmë në dorë të Maliq beut gjithshka që kemi vënë me djersën e ballit.

Zotërinj gjyqtarë! Maliq beu nuk i ka tapitë e tokave tona. Ne kemi dërguar njerëz gjer në Stamboll.

— Dëgjo, o plak, — e ndërpreu kryetari i kolegjit civil me një zë të vrazhdë — neve nuk na duhet se ç'keni ju në Stamboll. . . Përqëndrohu rreth thelbit të çështjes.

— Na falni, zoti kryetar, — kërkoi ndjesë xha Nini me shumë mirësjellje — se ne je-



mi fshatarë dhe nuk dimë të flasim si duhet. Atëhere, me lejen e zotërisë suaj, po vazhdoj. Historia e grindjes sonë me Maliq bej Frashërin, është kështu.

— Të thashë edhe një herë — e ndërpreu sërishmi kryetari — se neve nuk na duhen historira. . .

— Po çfarë ju duhet juve, zoti kryetar?

— A keni ju ndonjë shkresë që të provoni se i mbani tokat në mirëbesim ashtu siç e kërkon ligji? . . . Ja, këtë kërkojmë ne.

Xha Nini nuk po kuptonte gjë për sa po fliste kryetari. Megjithatë ajo puna e shkresës ju kujtua, ja kishte thënë avokati i tyre qysh në gjyqin e Korçës dhe ai u përgjegj i revoltuar.

— Për besë nuk po e marr hiç vesh se ç'kërkoni nga ne katundarët e shkretë. Shkresë! Po ne i kemi tokat tona denbabaden e nuk i kemi blerë. Nga do ta merrnim shkresën?!

— Mirë, mirë, vazhdo — tha kryetari i kolegjit me një ton sikur të thoshte që «për mua kaq mjafton, ti po deshe folë, po deshe rri në vend».

— Gjukata e Korçës, — vazhdoi xha Nini, megjithëse e dinte që të pesë gjyqtarët nuk e dëgjonin fare — besoi thënjet e dëshmitarëve të rremë që paraqitën avokatët e Maliq bej Frashërit. Të gjithë gënjyen pa pikë turpi. Ata thanë se Gorica paska qenë gjithnjë çiflik i Maliq beut, se ne kemi qenë bujqërit e tij dhe gjoja i kemi paguar çdo vit të tretën. Këto nuk janë të vërteta. Gënjeshtra e tyre doli që në gjyq. Kështu, kur jallanshahitët e Maliq beut thanë se na njihnin ne kokë për kokë, mbasi gjoja kishin qenë në fshat kur i kishin paguar beut të tretën, ne i pyetëm se si e kishim emrin, kurse ata nuk dinin ç'të thoshin. Kjo është shënuar edhe në procesverbal.

— Mjaft, mjaft! — e ndërpreu kryetari.

— Ne kemi kërkuar prej gjykatës së Korçës që të na lejonte të paraqitnim dëshmitarët tanë, por gjykatësi na ndaloi, duke thënë se duhet t'i kishim me vete.

Tek fliste xha Nini, pesë burra me kostumë të errëta qëndronin të heshtur matanë tribunës. Në fytyrën e tyre nuk dukej as emo-

cioni më i vogël, megjithëse ishte fjala për jetën e një fshati të tërë. Ata pothuajse nuk dëgjonin fare. Kryetari shfletonte dosjen sa për t'u gjendur në punë, një tjetër kruante thonjtë me vëmendje të përqëndruar në punën e tij, i treti ishte si përgjumësh dhe kështu me radhë. Të pestë prisnin me padurim sa të mbaronte xha Nini.

— A është e drejtë, zotërinj gjyqtarë, — përfundoi xha Nini — të hidhet në mes të katër rrugëve një fshat i tërë, me burra, gra e kalamaj, sepse nuk i nënshtrohet Maliq bej Frashërit? . .

Ne kemi jetuar denbabaden në Goricë; në ato toka nxjerrim bukën e fëmijëve, atje kemi varret e të parëve dhe, po të jetë nevoja, do të hapim edhe varret tona, por nga fshati nuk luajmë.

Xha Nini u ul dhe pas tij e mori fjalën avokat Konica.

— Kjo çështje ka rëndësi të madhe për familjen tonë, — tha ai në emër të Maliq bej Frashërit — e cila, brez pas brezi prej 200 e ca vjetësh, ka qenë zotëruese e këtij çifliku me

famë. Bujqërit e këtij çifliku kanë punuar në tokat tona duke na paguar rregullisht të tretën. Në vitin 1912, qëkurse midis 14 katundeve u okupua edhe çifliku ynë prej ushtrisë greke, bujqërit, domethënë të paditurit, të shtyrë nga elementë të jashtëm turbullues dhe duke përfituar nga muhaxhirllëku i familjes sonë, e cila aso kohe la mall e gjë dhe iku nga Korça, duke përfituar nga situata e keqe e krijuar prej luftës ballkanike, u deklaruan revolucionarë kundrejt neve të zotërve të çiflikut me aq rreptësi, sa nuk guxonim të afroheshim në çiflik. Në atë kohë na dogjnë hanë, edhe fabrikën e miellit, edhe kullën, kurse çobanë, të cilin e kishim dërguar për të shikuar gjendjen e çiflikut, e muarrën si spiunin tonë dhe e dogjën në furrë për të tmerruar të tjerët që mos të afrohej njeri në çiflik. . .

Në sallë s'pipëtinte njeri. Gjyqtarët dëgjonin me vëmendje avokat Konicën dhe herë pas here vështronin goricarët.

Zoti Mirdita, një gjyqtar i vjetër, që rrinte në krahun e djathtë të kryetarit, i pëshpëriti atij në vesh:

— Bie erë bolshevizëm kjo puna e gorica-rëve, zoti kryetar.

Ndërkaq avokat Konica vazhdonte fjalimin, i sigurt se kishte bërë me vete trupin gjykues.

— Të paditurit pretendojnë se tokat e Goricës janë në zotërim të tyre të ligjshëm. Ne u bëjmë një pyetje. A kanë ndonjë shkresë, e cila të ketë kuptimin e një titulli zotnimi për të provuar qëllimin (animusin) se e kanë mbajtur në mirëbesim, ashtu sikurse e kërkoneni 10 i ligjës «Mbi gjykimin e shpejtë të padinave posedimore?»

Ai kujtoi se nuk do të përgjigjej njeri, prandaj, u bë gati të vazhdonte më tej, por ja ku u ngrit Boçoja dhe e ndërpreu në mes:

— Po beu i ka tapitë e çiflikut, zoti avokat?

Kryetari i gjykatës e quajti këtë ndërhyrje si shkelje të rregullit dhe i ra ziles. Ndërkaq avokat Konica përfundoi pa e humbur gjakftohtësinë:

— Ne kërkohet të na lirohen gjithë trojet e katundit Goricë. Bujqërit kryengritës le të shkojnë në punën e tyre.

3.

Të pesë anëtarët e gjykatës së diktimit kishin për të zgjidhur një problem me rëndësi. Maliq bej Frashëri nuk i kishte tapitë e çiflikut dhe, me sa dukej, s'kishte pasur as posedimin e tij, të paktën njëzet vjetët e fundit, gjë që e pranonte edhe vetë. Flitej se Gorica i ishte dhuruar një stërgjyshi të tij si shpërblim për shtypjen e kryengritjes së maqedonasve, por për këtë s'kishte asnjë dokumentim. Të drejtat e tij mbi çiflikun e Goricës s'kishin asnjë bazë nga pikëpamja juridike, mirëpo si t'ja bënin? Maliq beu ishte bej. . .

— Pra ç'mendim keni ju, zotërinj gjyqtarë? — i pyeti kryetari kolegët e tij kur u tërhoqën në dhomën e bisedimit.

U ulën në kolltukë dhe ndezën nga një cigare duke biseduar lirisht.

— Atij plakut nuk ja hante qeni shkopin, — tha duke qeshur lehtë zoti Niko, një gjyqtar më i ri se të tjerët, që kishte mbaruar studimet në Francë.

— Pisk do ta ketë pasur punën me ta Maliq bej Frashëri — shtoi një tjetër.

— Me goricarët? — ndërhyri zoti Estref, që rridhte edhe vetë nga derë beu. — Mos e pyet! Ata janë kokëderra. T'i shtrosh në dru gjithë ditën ja, kështu e duan ata. . .

— Sidoqoftë, kanë një çikë të drejtë. . . — tha zoti Niko.

— Kanë të drejtë thoni ju, zoti Niko? — ndërhyri energjikisht Estref beu. — Akoma ju me ato idetë e ndritura të revolucionit francez: «Liri, barazi, vëllazërim!» Ç'vëllazërim? Me goricarët! Vëllazërohu pe deshe... Dru, ore, dru, kërbaç, ja kështu e duan ata. Por ke hakë ti je rehat, se të kishe nja dy-tri çifliqe si Maliq beu, do të të vinte festja vërdallë dhe do të flisje ndryshe. Këtu vjen erë bolshevizëm, zoti Niko. Rusia u ka prishur mendjen fshatarëve tanë. Duan tokat tashti, nesër kushedi ç'do të kërkojnë.

— Estref bej, mos u nxehni, — u tremb zoti Niko dhe filloi të tërhiqej. — Të kuptohemi, unë s'them që t'u japim të drejtë goricarëve dhe të lëmë Maliq benë pa çiflik, por ja, flas thjesht nga pikëpamja juridike. Maliq beu nuk i ka tapitë e çiflikut.

— Vërtet, po ç'rëndësi ka kjo? Ne nuk kemi padinë e themelit, por padinë posedimore — vuri në dukje Estref beu duke buzëqeshur me dhelpëri.

— Mirë, atëhere le ta shohim problemin nga ana posedimore. E ka pasur ndonjëherë Maliq beu këtë çiflik në zotërim të tij?

— Posi jo? E thonë dëshmitarët.

— Po, për parashkrimin ¹⁾, ç'do të thoshit ju, Estref bej? — vazhdoi Nikoja me argumenta juridike.

— Këtu jemi në rregull, — u përgjegj Estref beu me kryelartësi — janë zënë të gjitha shtigjet. Ligja e re «Mbi gjykimin e shpejtë

1) Parashkrim, quhet kështu shuarja e së drejtës së padisë, kur kalon afati ligjor.

të padinave posedimore», që doli kohët e fundit, cakton një afat njëvjeçar për ngritjen e paradisë. Kjo fillon nga dita e daljes së saj. Maliq beu e ka ngritur padinë brenda afatit.

— Dakord! — murmuriti Nikoja dhe u tërhoq në dritare.

Kryetari dhe gjyqtarët e tjerë dëgjonin me vëmendje. Ata e dinin se mendimi i zotit Niko kishte baza nga pikëpamja thjesht juridike, por nga pikëpamja politike ndryshonte puna. . . Fundi i fjalës nuk mund t'i jepej e drejta «opingës» dhe të lihej një bej pa çiflik!

— Mendimi im është ky, zoti kryetar — mori fjalën zoti Mirdita, një burrë tullac, fjalëpak dhe tepër i matur. — Nga ana e formës padia është ngritur brenda afatit njëvjeçar të parashkrimit që caktoi ligja e re «Mbi gjykimin e shpejtë të padinave posedimore». Në themel vendimi i gjykatës së paqit në Korçë është i drejtë dhe duhet të lihet në fuqi.

Pa mbaruar fjalën zoti Mirdita, ra zilja e telefonit. Flisnin nga oborri i Lartmadhërisë. Kryetari vuri receptorin në vesh dhe po dëgjonte me një nderim të veçantë.

— E shqyrtoat çështjen e Maliq bej Fra-
shërit, zoti kryetar?

— Jo, akoma, bej, për atë jemi mble-
dhur. . .

— E keni të qartë rëndësinë politike të
vendimit që do të merrni, zoti kryetar?

— Si urdhëron, e kemi, bej — u përgjegj
ai shpejt e shpejt.

— . . . dhe pasojat? — insistoi tjetri du-
ke i dhënë kësaj fjale dy kuptime.

— Si urdhëron, edhe pasojat!

— Shumë mirë, zoti kryetar, — u për-
gjegj tjetri i kënaqur, — por kolegët tuaj si
mendojnë?

— Si të them, bej, — tha kryetari duke
vështruar nga kolegët e tij — ne akoma nuk
kemi vendosur formalisht, por dakord jemi të
gjithë, bej. . .

Tek përgjegjej kryetari, katër anëtarët e
tjerë të gjykatës së lartë buzëqeshnin me kë-
naqësi dhe njëkohësisht tepër të emocionuar
që një personalitet aq i lartë tregonte vëmen-
dje për mendimin e tyre.

Kur mbaroi bisedën, kryetari i kolegjit civil të gjykatës së diktimit vuri me kujdes dorëzën e telefonit në vendin e vet dhe lëshoi një psherëtimë çlodhëse. Në ballë dhe në duar i kishin dalë bulëza djerse nga sikleti.

S'kaloi shumë dhe në korridor u dëgjuan hapat e një ushtaraku. Kryesekretari i gjykatës njoftoi se kishte ardhur një i dërguar i oborrit mbretëror dhe kërkonte zotin kryetar. Kur u hap dera, para anëtarëve të gjykatës së diktimit u shfaq figura e rreptë e një ushtaraku me mustaqe. Uniforma e stolisur pa kursim ja shtrëngonte trupin e dhjamur, por kapiteni i oborrit mbretëror e duronte trimërisht këtë vështirësi, mjaft që të dukej njeri i rëndësishëm me ato spaleta të arta, që i vareshin mbi supë dhe me gjithë ato nishane që i kishte varur Lartmadhëria nga viti 1924 e tutje.

— Tungjatjeta, zotërinj, — tha ai pa u ulur në kolltukun që i treguan. — Vij nga oborri mbretëror për t'i prurë zotit kryetar dhe zotërinjve të tjerë të gjykatës së diktimit këto ftesa për të marrë pjesë në pritjen që organizon të dielën Lartmadhëria me rastin e . .

Ata, të pestë, vështruan njëri-tjetrin të kënaqur. S'dinin se si ta prisnin më mirë kapitenin e oborrit mbretëror; e ftuan sërishmi të ulej në kolltuk, i ofruan një cigare, por ai nuk pranoi se s'kishte kohë.

Pasi i përshëndeti me një «Puna mbarë, zotërinj!», kapiteni i oborrit mbretëror bëri një prapakthehu sipas rregullores, çeli derën dhe doli kryelartë.

Kryetari propozoi që të vendosnin përfundimisht.

— Ç'mendim keni ju, zoti Qemal? — ju drejtua ai anëtarit të pestë të kolegjit civil, njeri indiferent e flegmatik.

— Dakord — murmuriti ai.

— Zoti Mirdita?

— Dakord.

— Estref beu?

— Dakord.

— Po ju, zoti Niko?

— Dakord.

Kur kryetari shqiptoi vendimin, tre goricarët mbetën në vend si tri lisa. Ata vështronin fytyrat e verdha e pa jetë të gjyqtarëve,

kostumet e tyre të errëta dhe u dukej sikur të pestë, si një trup i vetëm, kishin dalë nga errësira së bashku me vendimin e tyre.

— Jo! — tha xha Nini, ne nuk luajmë nga fshati!

— Ky vendim është i formës së prerë — u përgjegj shkurt kryetari.

— Le të jetë — ja ktheu xha Nini gjithë inat. — Ne nuk na shkulni që andej.

Kryetari nuk u përgjegj, nuk foli as edhe ndonjë nga anëtarët e tjerë të gjykatës së diktimt. Ata ishin mësuar me këto protesta të fshatarëve që humbnin gjyqin, prandaj, për të mos provokuar ndonjë të papritur, u larguan njëri pas tjetrit nga një derë, që ishte prapa tribunës.

Në sallë nuk mbeti njeri. Avokat Konica ishte larguar me kohë për t'i dhënë lajmin e gëzuar Maliq bej Frashërit, që priste në «Kristal».

Ata të tre dolën në verandë. Një fllad i lehtë që vinte përmes gjelbërimit, u freskoi fytyrën dhe u kujtoi se duhej të ktheheshin në fshat.

— Ecni, djema! — urdhëroi xha Nini.
— Do të luftojmë! . . .

Afër tyre, truporja e drejtësisë, e bardhë si bora, ngrihej gjithë dinjitet midis gjelbërimit, duke mbajtur në njërën dorë ballancën dhe në tjetrën një shpatë.

NJË DITË DHE NJË NATË

— Ngjarje e jetuar —

Ata ecnin të tre në brinjën tërë shkurre e gurë. Shpesh herë ishin të detyruar të ndaleshin, ose të ktheheshin edhe mbrapsht, për të gjetur një vend më të mirë kalimi. Të tre, burri me qeleshe, plaka me rrobe të zeza dhe vajza e veshur me një kapardinë bojë qielli ishin të vetmit, që ecnin në atë kodër. Po kush janë e ku shkojnë këta njerëz? Kodra i shmangej mjaft rrugës kalimtare dhe vendeve të punës nga shkonin zakonisht kooperativistët. Andej nuk kishte as edhe një fshat, sepse, më sipër, pas pyllit, vinte mali thikë. Ishte e ndryshme edhe veshja e tyre. Burri me qeleshe, dukej që

ishte nga vendi, ndërsa veshja e plakës me atë shallin e zi të hedhur mbi supe, si vello, nuk ishte karakteristikë për këto anë. Vajza, me një aparat fotografik në dorë e me fjongo të kuqe, ngjante si qytetare.

. . . Burri çante rrugën, disa metra përpara, ndërsa ato të dyja shkonin në gjurmët e njëra-tjetrës. Kur ndalonte, ose kthente rrugën i pari, ndalonin e ktheheshin edhe ato. Po të gjitha veprimet bëheshin në heshtje; midis tyre asnjë fjalë nuk shkëmbehej. Burri e kishte vënë re që në mëngjez se plaka ishte futur në mendime dhe nuk kishte dashur që ta shkëputte asnjë minutë nga ajo botë ku ishte futur. «Le të prehet me veten e saj, mendonte ai, kushedi se çfarë kujton e përfytyron». Dukej se bisedat e tyre kishin mbaruar qysh mbrëmë, kur pas darkës folën gjatë për këtë nisje. Edhe sot në mëngjez ai e pa plakën të mbështetur pranë oxhakut, duke tretur shikimin e saj në prushin e zjarrit, aq sa nuk e vuri re ardhjen e tij dhe nuk e përmendi nga mendimet që e kishin pushtuar. Vajza ishte ngritur në këmbë e shikonte nga dritarja. Ha-

jen e mëngjezit as që e kishin prekur.

— Gati? — e pyeti ai vajzën.

— Po — ju përgjegj.

Kaluan kodrën, pas së cilës u fsheh fshati, dhe para tyre doli një fushë e vogël, që po sa ishte punuar. Dredhuan anës saj dhe prapë vazhduan ngjitjen. Heshtja i shoqëronte në çdo hap.

Plaka u lodh. Frymëmarrja e saj po bëhej më e dendur dhe filloi të gulçonte. Dalëngadalë këto u kthyen në rënkime të lehta, që vajzës i nguleshin si gozhdë në zemër.

— A jemi ende larg? — pyeti ajo burrin.

— Edhe ca — ju përgjegj ai shkurt.

Vajza desh ta kapte për krahu plakën, por ajo nuk e la dhe nxitoi hapin që të arrinte burrin. Faqja e kodrës ishte mjaft e rrëpirë e ata kalonin në rrugë e pa rrugë. Vajza rrinte pas plakës, gati që ta ndihmonte po të rrëshqiste.

— U lodhe, nënë? — pyeti ajo gati me frikë.

— Mos më pyet më mirë, — ja ktheu ajo.

Vajza heshti e dëshpëruar, se e shikonte që asaj ju prenë fuqitë. Rrëpirës po i vinte

fundit. Burri u ngjit në majë e u kthye të shikonte shoqërueset e tij. Ato ndodheshin rreth 50 metra më poshtë se ai. U ul e filloi të dridhte një cigare. Plaka e vajza ju afruan, por ai nuk shikonte më andej. Kur e pa burrin në atë pozicion, plakës ju shkëput një «oh!» e gjatë, që nuk ishte një rënkim, por klithmë e zemrës që s'duronte dot në kraharor, ishte revolta e dhembjes shpirtërore që nuk gjente shteg të lirë për shpërthim. Vajza e kapi fort plakën nga mesi dhe e ndihmoi të kapërcenin edhe ato pak metra që u kishin mbetur. Sa arritën ato, burri u ngrit e nisi prapë rrugën. Plaka disi u qetësua dhe psherëtiu thellë. Bënë nja njëqind metra zbritje nëpër shkurre, por tanimë ecnin pranë njëri-tjetrit. Më tej zbriste një përrua i thellë, ndërsa nga sipër fillonte pylli që vazhdonte gjer në mes të malit. Burri befas ndaloi, hoqi cigaren nga goja dhe u kthye nga ato.

— Këtu — tha ai.

— Ku? — u hodh plaka.

— Këtu ku jemi. . .

— Ma trego vendin me pëllëmbë! — e ndërpreu ajo duke thirrur.

— Këtu u ndamë — tha me gjysmë zëri ai. Dukej tashmë se edhe burri nuk i nxirrte dot lirshëm fjalët. Edhe atij i ishte bërë një lëmsh në grykë. — Ja, këtu — vazhdoi ai, duke treguar dy gurë të mëdhenj — ne zumë vendet tona. Sapo zbritëm nga mali, lamë prapa pyllin dhe nxitonim për në fshat. Kishim dy ditë e dy net që udhëtonim nëpër dëborë për të zbatuar një detyrë urgjente, por ishim të gëzuar se po arrinim në kohën e caktuar atje ku duhej. Kur dolëm nga pylli shikuam me kujdes dhe, meqë nuk vumë re asgjë të dyshimtë, vazhduam rrugën. Kur sosëm këtu, dëgjuam një britmë të fortë: «Mos luani! Hidhni armët!» Të dy u shtrimë menjëherë barkas dhe ngrehëm pushkët. Nga ana e kundërt erdhi jehona e një zëri tjetër: «Jeni të rrethuar, prandaj mos bëni shumë naze».

« — Dëgjon, — më tha ai — na kanë futur në vathë — dhe qeshi.

— Pisk e kemi — i thashë.

— Pse? — m'u përgjegj.

— Zor se del nga kjo vathë e të poshtër-
ve.

— Edhe vatha ka një derë — më dha zemër.

— Në qoftë se nuk na e kanë zënë edhe atë — ja ktheva.

— Ta hapim ne! — ma preu.

Në këtë kohë përballë nesh u ngrit një figurë e madhe me mustaqe vesh më vesh e na thirri:

— Ore, kuqua i djallit, nuk e shikon se të kemi futur si shejtanin në shishe? Ç'do të bësh, apo do të fluturosh me krahë? — Dhe, për të na treguar më mirë mendimin e vet, lëvizi ato krahët e tij si të lejlekut. Krisi pushka e Astritit. Figurës i mbetën për një çast krahët të zgjatur anash, pastaj u shemb.»

— Të lumtë pushka, o bir! — shfreu plaka. Burri heshti pak dhe nisi prapë tregimin:

« — Disa sekonda pas kësaj nuk pati asnjë të shtënë, pastaj nga të gjitha anët filluan breshëritë. Astriti më tha:

— Një cep të vathës e hapëm, të qërojmë të tjerët.

Rrethimi po ngushtohej. Tani ata na

ishin afruar aq sa, nga ana e sipërme mund të na qëllonin edhe me bomba. Ja, këta gurët na kanë mbrojtur shumë. Ne qëllonim dhe ngandonjëherë bisedonim. Ç'është e vërteta asnjëri nuk kishte shpresa të shpëtonte, por Astriti donte të më jepte sa më shumë kurajë si më i madh që ishte. Kur filluan të na vinin në vesh bisedat që bënin armiqtë, Astriti u kthye nga unë:

— Ti do të ikësh, ndërsa unë do t'i mbaj ata që mos të të ndjekin ty.

— S'e kemi zakon ta lëmë vetëm shokun në rrezik, — ja ktheva i fyer.

— Në luftë ka zakone të tjera, që i krijojnë urdhërat — më foli ai. — Ti do të shkosh patjetër tek ai shoku e t'i japësh porosinë, që na kanë dhënë. Këtë detyrë do ta kryesh me çdo kusht, ndryshe i kemi humbur të gjitha.

Ai kishte të drejtë të më urdhëronte dhe unë duhej ta zbatoja, megjithëse isha i bindur, se, aq sa mund të shpëtonte peshku nga rrjeta, aq mund të dilja edhe unë i gjallë nga ajo grackë. Astriti më mori një pjesë të bombave

të mia dhe më këshilloi që, kur të më urdhëronte ai, unë t'ja mbathja. Pastaj më pëshpëriti: «Mos harro adresën e nënës sime!»

Plaka u drodh dhe filloi të fliste me vete: «Të keqen nëna, o bir, e dija që ti s'më nxirrje kurrë nga mendja. E mbajte fjalën që më dhe kur të nisa se, sido që të ndodhte, ti do të më dërgoje fjalën e fundit».

Burri heshti sa të qetësohej plaka, ndërsa vajza u shtrëngua më shumë pas supit të saj dhe fytyrën e futi në shallin e zi të nënës.

« — . . . Plumbat na vinin nga të gjitha anët dhe ne mezi nxirrnim kokën për të marrë shenjë. Ata afroheshin vazhdimisht. Astriti më zuri pushkën dhe ma bëri me dorë që të mos qëlloja më. Për një minutë e ndaluam zjarrin. Heshtjen tonë e pasuan dhe armiqtë. Ndoshta besonin se ishim vrarë, por nuk guxonin të lëviznin. Pas pak vura re se disa prej tyre ngriheshin e bënin nga katër-pesë hapa me kërcim e prapë uleshin.

— Mos bëj asnjë veprim, — më tha Astriti — le të afrohen akoma më shumë.

Unë nuk kuptoja se çfarë kishte ndër

mend. Ai më dha disa letra dhe më porositi të isha gati.

— Çantën do ta mbaj vetë, — shtoi — në të s'kam ndonjë material të vlefshëm për ta, ndërsa ne do të na shërbejë shumë.

— Pse? — e pyeta.

— Sepse, po u ra në dorë, ti do të përfitosh mjaft kohë për t'u larguar prej tyre.

E kuptoja gjithë përmbajtjen e vendimit të tij. Sytë m'u mbushën me lot dhe aty për aty vendosa që të mos largohesha nga ai, çfarëdo që të bëhej. Po ai më foli ashpër:

— Lëri përrallat dhe do të bësh ashtu si të urdhërojnë!

Në këtë kohë armiqtë po afroheshin më të shkujdesur, ndoshta na merrnin për të vrarë. Astriti u ngrit me rrëmbim dhe hodhi me shpejtësi disa bomba dhe më bërtiti që të nisesh për në përrua. Në atë tym e pluhur urdhëri i tij më çoi peshë me një forcë të pashpjegueshme. Nuk kuptoja se kush vepronte mbi mua, vetëdija apo urdhëri i tij, vetëm një gjë mbaj mend që, forca e zërit të Astritit më hodhi përpara. Rrëshqita në përrua me rrëm-

bim dhe në kalim e sipër më zuri syri armiqtë që prapësoheshin të lemeritur. Përroi ishte shumë i thellë e me ujvare të larta dhe në një rast të zakonshëm askush nuk do të merrte guximin të provonte kalimin nëpër të. Unë vazhdoja rrugën, ndërsa gryka e përroit më sillte në vesh të dhjetëfishuar jehonën e luftës, që bëhej sipër. Më në fund dola atje ku duhej dhe mora me vrull rrugën e fshatit. Dëgjova përsëri shpërthimin e disa bombave menjëherë. «Astriti po ua derdh prapë trutë të poshtërve», mendova. Këto gjëra vetëm i mendoja, sepse nuk kisha forcë të shqiptoja asnjë fjalë. Kur ju afrova fshatit tim, pashë burra të armatosur që po ngjiteshin përpjetë me nxitim. Ishin fshatarët e mi që merrnin pjesë në forcat territoriale. U thirra dhe vrapova andej. Kur arrita tek ata, nuk ndalova, por shkova me shpejtësi përpara. I kaloja gurët e shkurret jo sikur ngjitesha, por sikur zbrisja në rrëpirë. Ata pas meje, duke mbajtur armët gati në duar. Arritëm me një frymë në atë majën e parë, që kaluam bashkë. U ndamë në dy grupe të vogla që t'u merrnim krahët ballistëve. Kur po i ngjiteshim

rrëpirës, pamë ato egërsira që po iknin njëri pas tjetrit anës së pyllit me nxitim. Siç duket na kishin vënë re dhe po shpejtonin të iknin. Ishim mbi një kilometër larg, por i dallonim mirë që s'kishin asgjë me vete. Largësia nuk na lejonte t'i qëllonim, megjithëse e kuptonim se ata as që kishin ndër mend të na prisnin. I lamë të iknin dhe vrapuam për në vendin ku u ndamë me Astritin. Zemra na e desh ta gjenim të gjallë, ose të paktën t'i jepnim ndihmën e nevojshme, po të ishte plagosur. Kur u sosëm këtu, ku jemi tani, atë nuk e gjetëm. Vendi binte erë barut. Thirrëm e thirrëm, por përgjegje nuk morëm. Filluam të kërkonim dhe kërkua gati gjer në mbrëmje. Asgjë nuk gjetëm. Vendosëm të ktheheshim në fshat, duke menduar se edhe ai mund të kishte ndjekur rrugën që ndoqa unë e mund të takoheshim atje. Kjo shpresë na e mbante zemrën të ngroh-të. U fola shokëve për t'u nisur. I fundit erdhi Xhafa. Ai mbante dy pushkë në duar. Vinte drejt nesh i heshtur. Ne na u zu fryma. Ajo fiije shprese se mund të takoheshim, na kishte pushtuar aq shumë, sa nuk donim të besonim

vdekjen e tij. Unë e njoha atë menjëherë dhe e pyeta:

— Ku e gjete?

— Ja, atje, në mes të shkurreve — ma bëri ai me dorë.

— I vdekur?

— Jo, vetëm pushka ishte atje.

Filluam përsëri të kërkonim e të thërrisnim. Ra mbrëmja, por asnjë nuk u kthye në shtëpi asaj nate. Ndezëm zjarre e pishtarë për të ndriçuar vendin. Unë i bëja njëmijë pyetje vetes. Mos vallë ballistët e vranë dhe e hodhën në përrua nga inati që s'e kapën dot të gjallë, apo e la pushkën aty se ju mbaruan fishekët dhe t'i mashtronte me të, që të fitonte kohë? Po pse ta fshihte në shkurre? Për asnjë nga këto pyetje nuk gjeja zgjidhje. Që ta kishin marrë me vete, nuk besoja. U bë ajo natë vetëm drita e të thirrura. Të gjithë kërkonin e mendonin me vete. Dhjetëra pyetje e përgjegje të heshtura kalonin në tru. Kur zbardhi dita, ju futa përroit pëllëmbë për pëllëmbë dhe nuk pashë asgjë të dyshimtë. Ishte e çuditshme zhdukja e tij. Ai ishte tretur si kripa në ujë.»

Këtu burri me qeleshe heshti, ndërsa të dy gratë nuk kuptoheshin nëse merrnin frymë ose jo.

— Astritin e gjetëm në mbrëmje — e theu heshtjen burri.

— Ku? — pyeti nëna me zë të dredhur.
Burri u çua në këmbë.

— Hajdeni — tha ai. Ato e shoqëruan. Të tre njëri pas tjetrit bënë ndonja njëqind metra. Plaka nga larg filloi të dallonte një si gur të bardhë, i cili, sa më shumë i afroheshin, rritej e shndërrohej në një kolonë të lartë.

— Lapidari? — pyeti plaka.

— Po. Lapidari i Astritit — ju përgjegj burri.

Lapidari ishte vendosur në një si gropë me një fund të sheshtë sa një lëmë gruri, po që dallohej që së largu nga ana e poshtme. Në kolonën e mesme, që ishte më e gjatë se dy anësoret, mbi të cilat ishin vendosur ca lule, në një pllakë mermeri, ishte shkruar emri i birit të saj. Gruaja u afrua pranë pllakës, rrethoi me krahë kolonat dhe filloi të kuvendonte me veten e saj: «Biri im, biri im! Të gjeti nëna

aty, ku mbete! . . .» Nëna u qetësua dhe ja bëri me shenjë burrit të vazhdonte.

« — Afër mbrëmjes, — nisi ai — fillova të kërkoja një për një çdo kaçube e gur. Këtu ishte një ferrë e madhe dhe pashë që nga një krah dukej si e shkelur. Ju afrova mirë dhe pashë me vëmendje. Në mes ishte si gropë. Çava përpara dhe, sa bëra dy hapa, pashë Astritin të shtrirë me fytyrë nga qielli. Me një dorë mbante kapën, me tjetrën kishte ngjeshur çantën mbi plagën e gjoksit.

— Bir i nënës.

Qëndrova shumë pranë tij, duke qarë e menduar se si kishte arritur gjer aty. Patjetër duhej të kishte ikur atëhere kur dëgjova shpërthimin e atyre bombave. Ndoshta në ikje ishte plagosur. Pushkën pa fishekë s'kishte pasur fuqi ta merrte dhe e kish lënë atje ku e gjetëm, ndërsa vetë, për të mos rënë në dorë të tyre ishte përpjekur të tërhiqej në një vend që të mos binte në sy. Ballistët, ndofta, nuk arritën ta ndiqnin. Shkova e thirra shokët e tjerë. Erdhën burra e gra. E morëm dhe e varrosëm atje, ku kishim varrosur njerëzit e

farefisnin tonë. Të nesërmen, pasi i lashë lam-tumirën, u nisa për në çetë. Detyrën e plotësuam, por unë dhe e gjithë çeta humbëm shkollën tonë. Mora me vete të gjitha sendet e tij dhe në rastin më të parë t'i nisja sipas porosisë që më la. Ja, kështu ndodhi kjo ngjarje» — përfundoi ai.

Nëna u ngrit prapë, pushtoi lapidarin me krahë dhe vazhdoi ligjëratën e saj: «Biri im, e mësoi nëna se si luftove dhe u vrave, e mësoi atë që ka dashur prej vitesh. Të pata të vetëm, por s'më le të vetëm. Këtu ka ardhur edhe jot bijë, ajo është tani aq sa ishte ti kur u vrave. Ajo s'të pa të gjallë. Po të shikon të mermertë. S'të ledhatova kur u vrave, por po të ledhatoj tani». Nëna puthi edhe një herë pllakën e mermertë me emrin e të birit.

Aparati fotografik në dorë të vajzës shkrepiti disa herë.

U nisën të tre ashtu siç kishin ardhur. Nëna ishte tani më e qetësuar dhe bisedonte me shoqëruesin për çështje të ndryshme, ndërsa vajza rrinte e heshtur, ndofta ajo nuk e shkëpuste dot mendjen nga ngjarja që kish dëgjuar për vdekjen e të atit.

XHAFERR MATUKA

BUKA

Pas luftimesh të përgjakshme me armikun, çeta partizane e detyruar nga gjendja e krijuar, ishte ngjitur lart në një mal të mbuluar me dëborë. Çeta ishte e vogël, megjithatë, ajo kishte zhvilluar luftime të pandërprera për disa ditë, duke i goditur fashistët, natën e ditën, atje dhe atëhere ku ata nuk e prisnin. Tani çeta ishte tërhequr lart në mal e po priste rastin për t'u hedhur prapë në sulm. Kolonat armike që kishin ndërmarrë një operacion kundër lëvizjes nacionalçlirimtare në atë krahinë, po endeshin nëpër fshatra si bisha.

Ishte mesi i dimrit. Bora, si qilim i bardhë, kishte mbuluar gjithshka përreth. Vetëm lisat e mëdhenj, bojë hiri, të zhveshur nga fle-

tët, prishnin bardhësinë e vendit. Frynte një erë e ftohtë. Partizanët ishin mbledhur grupe-grupe rreth trungjeve të lisave për t'u mbrojtur nga era. Aty, midis atyre lisave, ishte një shpellë e vogël, e cila nuk merrte brenda më tepër se dhjetë - dymbëdhjetë veta. Por, meqenëse shpella nuk e merrte të gjithë çetën, asnjë nuk pranonte të futej e të strehohej në të. Vetëm me këmbënguljen e të gjithë shokëve, u rregulluan atje dy partizanë të plagosur dhe një shoqe që i mjekonte ata.

Çeta, që kur kishte filluar veprimet luftarake kundër armiqve, kishte vuajtur për ushqime dhe me vështirësi kishte mundur të siguronte diçka për të ngrënë. Por tani partizanët kishin më tepër se tri ditë pa futur asgjë në gojë. Intendenti i çetës bashkë me një partizan kishin ikur një ditë më parë për të gjetur bukë dhe akoma nuk ishin kthyer.

Të gjithë e ndjenin lodhjen dhe këputjen fizike që vinte nga mosngrënja, por mendohehin të mos e tregonin. Komisari herë pas here bënte mbledhjen e gjithë çetës dhe zhvillonte punë politike, kritikë e autokritikë e të tjera.

Jo rrallë pas trungjeve të lisave dëgjoheshin këngë revolucionare. Megjithëse po kalonin çaste të vështira, nga shpella ku qenë shtrirë partizanët e plagosur, buçiti kënga e tyre e bashkuar me zërin e shoqes:

Ato maja rripa — rripa se ç'gjëmojnë,
ndizet lufta për liri e derdhet gjak,
Janë trimat partizanë që luftojnë,
janë bijtë e Shqipërisë që marrin hak. . .

Një nga partizanët më të vjetër të çetës, në çastin kur dëgjoi këngën e shokëve të plagosur, u çua papritur në këmbë, ktheu kokën andej nga gryka e shpellës nga e cila derdhe-shin tingujt e këngës revolucionare, dhe po dëgjonte. Ai e dinte që të dy shokët ishin plagosur rëndë dhe shpëtimi i tyre nga vdekja, në ato kushte, qe me pikëpyetje. Megjithatë, ata edhe tani në majën e malit midis dëborës dhe akullit, të uritur e me trup të copëtuar nga plagët e hapura prej plumbave të armikut, po këndonin këngët e revolucionit. Partizanit i rrëshqitën pika loti përmes faqeve të zbe-

ta dhe, për çudinë e të gjithë atyre shokëve që qenë aty me të, pasi u koll një herë mbytu-razi, nxori kamën e tij dorezëargjendë nga mi-lli dhe me shpejtësi nisi të hapte borën dy — tri metra larg trungut të lisit. Shtresa e dëborës ishte e trashë dhe e ngjeshur gur, por ai vazhdonte me majën e kamës ta thërmonte. Pas një copë here u zbulua dhe toka e zezë. Ai pa humbur kohë mblidhte aty kokrra lëndësh e i futte në gji.

— Ç'i do, ato s'hahen — i tha një shok.

— Po të jenë të lisit të egër vërtet s'hahen, por, po të jenë të lisit të butë, hahen që ç'ke me të, vetëm se duhet të piqen në zjarr — ju përgjegj ai dhe, pasi kishte mbledhur nja dy grushte lëndësh, u nis për në shpellë. Aty shpejt e shpejt, me lejën e komandantit të çetës, shkrepiti me urorë dhe ndezi një zjarr të vogël, aq sa të mos bënte shumë tym e të diktohej. Pastaj, pasi poqi lëndët, ua dha të plagosurve. Mirëpo ata ngulën këmbë dhe nuk pranuan t'i dallonin nga shokët, kështu që të gjithë partizanët morën nga një kokërr. Përveç partizanit që i përgatiti, të gjithë të

tjerët për herë të parë po e provonin shijen e lendeve të lisit.

Pas pak u kthye intendentit. Shokët e panë që larg. Ai vinte vetëm, me kokë të ulur dhe ecte ngadalë, sikur mendohej thellë për diçka. Ai vazhdonte të ngjitej lart malit, për në çetë. Ecte vërtet ngadalë, po shokëve, që e prisnin me kohë ardhjen e tij, u dukej sikur ai s'levizte fare nga vendi. Të gjithë që nga larg po e shikonin atë që ecte kokulur dhe vetëm. Një ndjenjë shqetësuese i pushtoi shokët e çetës: «Pse ecën ashtu, ai e di që ne e presim që të na bjerë diçka? Po shoku që shkoi me të, ku është?»

Më në fund ai arriti midis çetës. Dukej i rraskapitur e i këputur, fytyra i qe zbehur më shumë nga ç'ishte një ditë më parë.

— Vdekje fashizmit! — përshëndeti dhe, pa i shikuar shokët në sy, hoqi nga supi një trastë dhe e vuri me kujdes, sikur të kish-te brenda në të diçka që thyhej, midis partizanëve.

— Liri popullit! — ju përgjegjën.

— Po shoku ku është? — e pyeti komisari.

Ai nuk u përgjegj menjëherë. Ndejti një çast pa folur me sytë të ngulur në borën e bardhë, pastaj shikoi fytyrën e dobësuar të komisarit.

— Shoku u vra! — u përgjegj ai me zërin që i tradhëtoi ngashërimin e brendshëm. — Shoku u vra! . . . — e përsëriti prapë pas pak dhe tregoi rrethanat në të cilat kishin rënë në përpjekje me armiqtë.

Çeta u hidhërua për vrasjen e partizanit dhe me propozimin e komisarit e nderoi kujtimin e tij duke mbajtur një minutë zi e duke u betuar për të marrë hakun.

— Ne të dy mundëm të gjenim vetëm ato bukë, që janë aty në trastë. Merrini e i ndajini.

— Ndaji vetë ti — i tha komisari.

— Jo, unë do të nisem prapë për të gjetur bukë — u përgjegj ai dhe, pa pritur përgjegjen e komisarit, me automatik në krah u nis poshtë.

— Prit, shok, merr edhe ti racionin tënd, — i thirri komandanti i çetës.

— Kam ngrënë — u përgjegj ai, me zë

të ulët sa mezi u dëgjua dhe vazhdoi të ecte poshtë.

Por intendent, ashtu si dhe shokët e çetës, nuk kishte ngrënë asgjë dhe ishte i uritur e i lodhur nga rrugët e gjata sa edhe të tjerët.

Për të ndarë bukë, u caktua një partizan. Ai mori trastën dhe që aty nxori dy bukë misri të pjekura në vatër, një kokërr qepë e pak kripë, të lidhura në cepin e një shamie.

Shokët ishin mbledhur në formë rrethi. Një partizan, pasi shkoqi në pulqerin e dorës disa fletë të thata lisi, me një copë gazetë pleksi një cigare dhe po e thithte thellë.

«Si t'i ndaj? mendonte partizani. Qysh t'u jap të gjithëve barabar? Këta të gjithë janë njëlloj të uritur!»

Pasi u mendua pak, ai u çua dhe i ndjekur nga sytë e të gjithë atyre që ishin aty, shkoi më tutje dhe theu një degë lisi. Pastaj shpejt e shpejt, nga dega preu me thikë dhe përgatiti një furkë, të cilën e nguli në mes të borës së ngrirë. Bëri dhe një shkop dhe e lidhi në furkë. Në dy anët e shkopit vari dy shami dore si ballanca, dhe kështu aty për aty sajoi

për çudinë e të gjithëve, një peshore pak a shumë më të saktë se syri e dora. Partizani u ul këmbëkryq mbi borë para «peshores». Të dy bukët i vuri nga e djathta e tij, mbi trastë, dhe nxori thikën e po i priste në copa të vogla, duke u munduar të bënte sa më pak thërrime.

Pasi i preu bukët, partizani hoqi nga gjerdani i tij një ballë fishekësh maliheri dhe e vuri në njerën anë të ballancës, kurse në anën tjetër vendosi një copë bukë.

— Hajdeni, shokë! — ju drejtua ai partizanëve. — Hajdeni me radhë.

Asnjë nuk lëvizi nga vendi.

— Hajdeni, mos na vononi! — u tha ai prapë të gjithëve pa ju drejtuar ndonjërit.

Prapë asnjëri nuk lëvizi nga vendi. Të gjithë po shikonin shokun që po peshonte dhe copat e bukës. Ata qenë të uritur, shumë të uritur. Fytyrat e të gjithëve ishin bërë limon, rrathët e syve u qenë bërë mavi, kurse sytë vetë sikur ishin futur më thellë. Ata kishin uri, por asnjëri nuk po afrohej të merrte atë copë bukë. Partizanëve nuk u largohej nga

mendja shoku që u vra për të siguruar ato dy bukë misri!

— Shokë! — e theu heshtjen njëri nga partizanët. — Unë mendoj që këto bukë t'ua lëmë shokëve të plagosur dhe shoqeve të çetës. Si thoni ju?

— Mirë e ke!

— Dakord!

— Ashtu le të bëhet! — u dëgjuan zërat e të gjithë atyre që qenë aty.

Por shoqet kundërshtuan.

— Ç'është ky dallim për ne, shokë? Ne jemi partizane dhe nuk pranojmë të na dalloni nga shokët — foli njëra nga ato.

Pas pak edhe që nga shpella u dëgjua një zë:

— Shoku komisar!

Të gjithë kthyen kokat andej. Aty te gryka e shpellës mezi sa ishte ngritur njëri nga shokët e plagosur, i cili kishte lidhur kokën me një shami të verdhë, por që tashti gjaku ja kishte ndryshuar ngjyrën.

— Shoku komisar, as ne nuk duam të na dalloni nga shokët. Neve ose të na jepet

sa të tjerëve, ose mos na jepni fare. Bukën le ta hani ju që do të niseni për luftë — tha ai me zë të këputur, por të vendosur.

Komisari u mendua një çast. Edhe atë ashtu, si shokët e tjerë, e kishte kapur një brengë e rëndë, por ai, pasi u mendua pak, urdhëroi:

— Shokë, të gjithë merrni pjesën e bukës!

Partizanët, një nga një afroheshin para shokut të tyre, dhe, pa e shikuar atë në sy, zgjatnin dorën e merrnin copën e bukës, pastaj largoheshin disa hapa më tutje. Partizani që kishte zëvendësuar intendentin, pasi peshonte bukën, e nxirrte atë nga shamia, i hidhte sipër disa kokrra kripë dhe me kujdes ja vinte shokut në pëllëmbë të dorës. Ai i shikonte shokët në sy, me një keqardhje të brendshme që s'mund ta shprehte. Shokët kalonin me radhë. Ja, para tij një partizan i ri, sytë e të cilit, të lodhur ishin ngulur në copën e bukës që po peshohej. Pas tij erdhi një partizan i vjetër dhe më i moshuar nga të tjerët, të cilin e njihte e gjithë çeta që hante shumë. Ai u afrua dhe po

priste. Partizani që ndante bukën, nxori nga gjerdani një ballë fishekë prej të cilit hoqi një fishek dhe e vuri, mbi pesë fishekët e tjerë që ishin në ballancë, pastaj vuri bukën dhe, pasi e peshoi, ja zgjati partizanit. Partizani, i cili e pa këtë, desh të largohej pa e marrë as pjesën që i takonte. Si duket i erdhi rëndë të trajtohej më mirë në këto rrethana të vështira për të gjithë.

— Merre një fishek më tepër, ta jap nga pjesa ime — i tha partizani që ndante bukën.

Por, si veprimin e partizanit që ndante bukën, ashtu dhe të partizanit që nuk e mori bukën, i vuri re edhe komisari i çetës, që qëndronte aty më këmbë i mbështetur në grykën e pushkës.

— Kthehu, shok, merr bukën! — ju drejtua ai me zë të prerë partizanit që po largohej.

Ai u kthye, mori copën e bukës dhe u largua.

I erdhi radha edhe një shoqeje, një partizaneje të re. Ajo po qëndronte me sytë e ngulur mbi fytyrën e partizanit intendent. Atij, duke ja dhënë në dorë copën e bukës, i ra mbi

borë një pjesë sa një gjysmë mëllëri. Shoqja, shpejt u ul, e mori dhe menjëherë e futi në gojë bashkë me kristalet e borës që i ishin ngjitur, dhe u largua tutje.

Duke ecur, asaj ju ngulën sytë mbi krodhën e bukës që mbante në dorë, ku ishte një pikë e kuqe sa një majë gjilpëre. U ndal dhe po e shikonte me kujdes: «Ç'të jetë? — mendonte me vete. Bojë? Jo! Gjak?» U kthye ashtu pa u vënë re afër partizanit që ndante bukën dhe po shikonte e përqëndruar trastën. Partizani mblodhi ca thërrime që kishin rënë aty mbi borë, i ngjeshi në grusht dhe ja zgjati.

— Na, merri dhe këto thërrime — i tha ai.

— Jo, nuk erdha për ato — ju përgjegj ajo dhe uli kokën e u largua me hapa të ngadaltë e me sytë të ngulur në dëborën e bardhë sikur kërkonte diçka.

«Është gjak. . . Po, është gjaku i shokut që u vra,» mendonte ajo me vete. Ja edhe trasta në një vend, po ta shikoje me kujdes, kish njollë gjaku».

Shoqja u largua, pak nga të tjerët, dhe,

duke derdhur lot, hapi një gropë me qytën e pushkës në borën e ngrirë dhe e futi atje copën e bukës që shtrëngonte në dorë, mbi të cilën dukej si rubin pika e gjakut të shokut. Pastaj ajo e mbuloi atë dhe u kthye në mes të shokëve pa u thënë gjë atyre.

Kur i erdhi radha partizanit që ndante bukën për të marë copën e tij, ai hoqi nga balla e fishekëve që ishin në ballancë një fishek dhe e la atë me katër. Pastaj peshoi bukën dhe e vuri mënjanë.

Komandanti dhe komisari e morën racionin e bukës të fundit.

Pas pak çeta u nis përmes tufanit për të filluar sulmin mbi fashistët.

NJË LAPIDAR PRANË PIRAMIDËS

Nën hapat e rëndë të çizmeve të tyre, kërciste dëbora gjysmë e ngrirë. Në qafë u rëndonte rripi prej lëkure i automatikëve të varur. Në të majtë të brezit u lëkundeshin bombat e dorës, që u dukeshin si dardha dimërore. Çapitnin mengadalë në atë çarçaf të bardhë, të pastër e të fshirë aq mirë nga era si me fshesë të madhe dhe të padukshme, duke lënë nga prapa gjurmat e thella të tabanëve të çizmeve. Por nuk qëndronin shumë e ato gropa të gjurmëve mbusheshin përsëri me flokët e dendur të borës. Disa metra i ndanin nga piramida, nga baza e tyre që dukej si një sfond i largët në mizërinë e shtëllungave të bardha, që shtjelloheshin nga era e fortë.

Prej së largu dukeshin si tri silueta të

mbështjella me pelerina të bardha. Sa lart që ishin ngjitur! Dhe nga ajo lartësi dukej një panoramë e bukur dimërore e atyre greminave të thepisura të malit dhe më poshtë, liqeni i kredhur i tëri në mjegull.

Veç zhurmës fishkëlluese të murlanit nuk ndihej asgjë tjetër.

— Sa vend i bukur! — tha studenti. Ish një djalë nga qyteti që posa kishte mbaruar institutin dyvjeçar.

— Shumë i bukur! — ja priti mekaniku, edhe ky nga qyteti.

— T'i shikoni këto shkrepë në verë, atëhere me të vërtetë do të mahniteni! — tha djaloshi prej malësie, i cili ishte në muajin e fundit të shërbimit dhe i njihnte me pëllëmbë këto anë.

— Çudi si ndahet kufiri në tokë, me piramida, ndërsa në hartë vetëm me vijë! . . .

— filloi të filozofonte studenti.

Qielli u nxi. Cingërima shtrëngoi. Furtuna filloi.

Gjurmat e lëna nga tabanet e çizmeve të rënda të të tre ushtarëve filluan të zhduke-

shin ca më shpejt. Në atë mugëtirë tri shikime luhateshin tej e tej nga piramida e treteshin në disa ktheпа të rrezikshme. Duart e tyre shtrëngonin fort armët automatike.

— Pikërisht si sot ka qenë ajo ditë, — vazhdoi malësori kur unë dola për të parën herë. Na udhëhiqte një kapter nga Kuçi. Ishte trim i madh dhe i zgjuar. Kishte sy të mprehtë. Ecja kështu siç jam tashti, flisja për gjëra të zakonshme, kur, papandehur, dëgjoj një breshëri automatiku dhe një urdhër: «Bar-kas!» — Nuk e di se si u shtriva, po mbaj mend që e ndjeva kokën të zhytur brenda në dëborë. Atëhere ndjeva drithmën e parë, edhe turpin e parë. Nuk e vura re aty për aty se kush qëlloi i pari, pastaj e mora vesh nga shoku pranë se kapteri ynë kish parë matanë diçka që nxinte. Ndërkaq nga lisi i gjatë u var si një bollë e madhe, duke shkundur dëborën nga degët një trup me. . . fytyrë njeriu.

— Mos lëviz! Lësho armët! Duart lart! — briti edhe një herë kapteri dhe, duke na urdhëruar që ta ruanim, u derdh vetë e ja lidhi duart shkelësit të kufirit.

— Po tani ku është ai? — pyeti studenti.

— U vra. Kjo ndodhi disa kohë më vonë. Përsëri ishim bashkë. Këtë radhë na erdhën papandehur disa breshëri prapa krahëve. Dhe gjithë plumbat ranë mbi kapterin. Tashmë unë isha mësuar me të papritura. . . u plagos dhe shoku pranë. . .

— Veç kësaj, ju shpëtuan edhe ata? — tha me dëshpërim mekaniku.

— Jo, asnjëri nuk shpëtoi. Ishin pesë veta.

— Po kush i asgjësoi? — pyeti përsëri mekaniku, që nuk u besonte syve, se pikërisht udhëheqësi i tyre ishte ai, që i kishte asgjësuar armiqtë dhe pastaj kishte zvarrisur shokun e tij të vrarë deri në postë.

Ndërkohë malësori ngriti kokën përpjetë dhe, për të mos u mburrur, ndërroi menjëherë muhabetin.

* * *

— Sikur filluan të më kërcasin dhembët. . . — tha studenti.

— Ama kaq i fortë qenke? — u tall mekaniku.

Malësori futi dorën në xhep, nxori një cigare, e vuri në gojë dhe me shpejtësi të madhe e ndezi me shkrepse,

— Çudi! — tha mekaniku. — Sa jam munduar të ndez një cigare kur ka erë dhe s'ja kam arritur, kurse ti. . .

— Është një teknikë e marinarëve. . .

Një furtunë e fortë cingëruese, me sllogje të mëdha dëbore gjysmë të ngrira u përplas në fytyrat e tre të rinjve.

— Mos u trembni! — ja pat malësori. — Kështu e ka dimri këtej. . . — Po pastaj filloi të dyshonte. Kjo furtunë paralajmëronte një diçka më të keqe, një tufan, një ngricë më të madhe, një blokim! . . .

— Po në qoftë me kaq, por, po na erdhi edhe një tjetër, mbarova fare. . . — ja ndërpreu mendimet mekaniku.

Malësori qëndroi në vend. Ngriti kokën lart, e ktheu anash dhe prapa. Fytyra e tij, e cila s'dallohej mirë në atë puih të dendur flokësh bore dhe furtune bashkë, ndërroi menjë-

herë. Ishte e kotë që ta fshihte. U hodhi një sy shokëve. Edhe ata kishin qëndruar dhe po prisnin se ç'do t'u fliste shoku i tyre më i vjetër.

— Shikoni, djema! — e filloi ai ligjëratën. — Koha është e keqe, do të fillojë një të ftohtë i madh, dëbora do të shtohet akoma më tepër. Zjarr këtu nuk kemi, vend ku të strehohemi nuk kemi. Meqë është akoma shpejt, ju shkoni, rrugën mund ta gjeni, mbani gjithmonë nga e djathta e përroit.

— Po ti?

— Unë do të rri vetë!

— Si na flet kështu? — ja befi studenti duke zbuar mendimet e tij.

— Pse, ç'jemi ne, kalamaj? Apo pse jemi qytetarë. Kujton ti se nuk e durojmë dot të ftohtët? Natyrisht, mund të kemi bërë shakara ose naze kur morën shërbimin. . . po, jo sa të arrijë puna deri këtu. Në vend që të na kërkosh ndihmë, ti do të na heqësh qafet. Nuk e prisnim prej teje këtë gjë — foli me inat mekaniku.

U ndezën gjakrat.

Bora filloi të dendësohej shumë. Temperatura sa vinte e ulej më tepër. Asnjëri s'ankohet. Tufani uturinte me tërë forcën e tij dhe herë-herë sikur i merrte me vete e i përplaste në dëborën e ngrirë. Ata ngriheshin menjëherë, nuk ankoheshin. Vigjëlonin. Asnjëri s'mendonte për veten e tij, asnjëri s'shikonte këmbët e tij. Secili mendonte për tjetrin. Shoku ishte më i dashur se vetja, dhe atdheu më i dashur se çdo gjë.

— A keni të ftohtë! Mërdhini nga pak?
— u foli me të butë malësori.

— Kur s'po na del ndonjë ujk përpara e. . .

— . . . Ta vrisnim e të futeshim në lëkurën e tij. Besa të pjell shumë mendja! — qeshi studenti.

Mundoheshin si e si të gjenin ndonjë bisedë për të kaluar kohën, për të duruar. Por era nuk i linte të flisnin shumë. Pastaj edhe armiku mund. . . megjithëqë ishte një vend dhe një kohë që armiku nuk të dëgjonte lehtë.

Mugëtirë! Vetëm piramida qëndronte si një siluetë e palëvizshme. Duart e ushtarëve

shtrëngonin fort automatikët e varur në qafë. Furtuna, ngrica, bora po bënin punën e tyre. Cilat kishin ngrirë? Duart e tyre, apo armët e tyre? Ndoshta të dyja, ndoshta asnjë. Por që të dyja ishin shtrënguar aq fort, sa nuk shqiteshin dot.

«Çuditem me këta qytetarët, sa shumë që e durokan të ftohtët. Asnjëri nuk ankohej. Po sikur të ankohej ndonjëri, sa pisk do ta kisha! Ah, kjo era ma thau faqen e majtë!.. Kushedi si janë bagëtia tashti. Do t'u kenë ngordhur shumë... Apo jo, se u kanë bërë stalla të mira e të ngrohta... Besa kjo kooperative e shpëtoi bagëtinë... Më shkruante vëllai se dushk kanë prerë për bagëtinë... Domethënë ato të siguruara janë... Po bujqësia? Oho, ky dimër i bën mirë bujqësisë, sidomos pemëve, nuk i lë të çelin para kohe. Edhe gruri mirë është. Nën dëborë ai rri ngrohtë... Pra çdo gjë në rregull qenka. Sa mirë!.. Po ajo si është? Po më pret me padurim. Ja, le të presë edhe dy-tre muaj e pastaj tërë jetën do të jemi bashkë...»

— Si jeni, shokë? — ja pat mekaniku.

— Mirë! — tha malësori. — Po studenti si është?

— Në formë fare. . . — Era ja mori fjalën nga goja dhe ja përplasi diku larg, në ndonjë shkëmb.

«M'i lumtë studentit. Unë s'kisha besim tek ai, ai po na del më gjakftohtë, nuk i bën syri tër. . . i qetë, gjithmonë i qetë. . . Se si po më dukeni ju, o këmbë! Ma paçi borxh këtë që po më bëni sot. Doni të më turpëroni përpara studentit e malësorit? Bëni sikur nuk jeni mësuar në të ftohtë. Shikoni, kemi mbremje në qytet këtë javë, prandaj duhet të jeni në formë. Pastaj këtë verë kemi festivalin e ushtrisë në Tiranë. Do të vete në uzinë. Atje do t'u vete shokëve, kështu i veshur siç jam, ushtar. . . Do ta takoj edhe atë. Unë e di që ajo më do me të vërtetë. . . Po s'ka guxim të ma thotë. . . Po unë kam guxim? Kjo ngriçca se si më duket, sikur ma thau hundën fare. . . Këmbë, mbahuni. . . Ç'bëjnë të tjerët?»

— O malësor, do të më ftosh mua në dasmë?

— kumboi më të fort zëri i tij.

— Po mua? — ja pat studenti, si i zgjuar nga një agoni e rëndë.

— Të dyve do t'ju ftoj një javë më parë.

— Ashtu de!..

Përsëri një suferinë e acartë ua ndërpreu bisedën në mes.

«Ah, sa më vjen për të fjetur, sikur të isha në kapanon. . . do të isha ngrohtë. . . por jo! (u shkund një herë) duhet mbajtur vetja. Ç'është ky gjumë tashti, në këtë kohë kaq të keqe, në këtë ngricë... në këtë dëborë?.. Kushedi ç'mendon nëna tashti. Me siguri që do të më ketë parë përsëri në ëndërr. . . Ja, edhe ca, durim. . . Mos të më zërë gjumi, se ky gjumë nuk është i mirë. . . duro edhe ca, me siguri do të vijë ndihma. . . e aq është puna, pastaj. . . do të kalojë çdo gjë. Patjetër, ç'më shkruante nëna?» Ki kujdes mos të ikësh pa leje. . . Apo sa bukur më shkruante motra e vogël «Dëgjon apo jo?..»

Suferina tjetër ja thau faqen fare.

«Shiko!:

I dashur vëllaçko. . . Sot na erdhën disa kufitarë në shkollë e na folën për heroizmat e

tyre. Po sa bukur që na flisnin se? . . .» Harrova çfarë shkruante tjetër. Mblidhe mendjen: «Na erdhi dhe ai ushtari që ua priti bombën me dorë diversantëve e ua përplasi në kokë duke i bërë fër. . .» Pse më shkëputen kështu mendimet? Mblidhe veten, kujtoje deri në fund letrën. . . «duke i bërë fërtele. Ai, i dashur vëllaçko, ishte më i shkurtër se ti, më i dobët se ti. Po ti je aq i fortë sa ai? A ke kapur ndonjë diversant? Do të më pëlqente të të shihja edhe ty në mes atyre trimave kufitarë, e t'u thosha shoqeve të mia: «Shikoni vëllanë tim, ai ka kapur diversantë të gjallë!». .

Ata s'levizën më. Asnjëri s'desh t'i tregonte shokut se ç'ndjente në atë çast, ose më mirë të themi, se ç'pjesë të trupit nuk ndjente. Për ata s'kishte gjë më të shtrenjtë në atë kohë se detyra. Asnjëri s'mendonte për vdekjen.

Disa pelerina të bardha u dalluan larg, shumë larg. Ato po afroheshin. Po çanin me vështirësi. Po vinin.

Syri i mprehtë i malësorit mundi t'i dallonte se ata ishin shokët, që u vinin në ndihmë dhe nxori një klithmë! E vetëm kaq!

Asnjëri nga shokët nuk ju përgjegj. Asnjëri s'kërkoj ndihmë. Asnjëri s'lëviz nga vendi. As malësori vetë! Suferina vazhdon të frynte më me tërbim. Qerpikët e të treve nuk lëviznin. Tashmë ata ishin bërë gjemba. . .

Si një rrapëllimë e fortë, tufani vazhdon të shkulte nga vendi topa të mëdhenj bore e t'i hidhte tej greminave, duke formuar herë-herë ortiqe të fuqishme, që rrokulliseshin shkëmbinjve të thepisur. Të tre vigjëlontin. Kapat e tyre të rrasura thellë në kokë, ishin ngurosur. Sytë e tyre ishin hapur. Lotët që u kishin mbetur nga cikna e fortë, kishin krijuar nga një lentë kristalini, që vështronte armikun që vigjëlonte.

Ata s'kishin vdekur. Ata qenë gjallë. Që të tre shtrëngonin armët e tyre të ftohta për të mbrojtur gjënë e tyre më të shtrenjtë. I shtrëngonin për të mos i lëshuar kurrë. Dhe nuk i lëshuan nga duart deri sa krijuan një lapidar përpara piramidës.

Ata ishin njëzetvjeçarë. Që të tre ishin kufitarë.

K A M A R J A

Abdurahman Arbana, portieri ynë, rri në kabinën me një kamare të vogël, pi duhan dhe mendon. Nuk e di njeri së ç'mendon! Ne të gjithë nuk e dimë se ç'mendon. . . Unë vetëm ja marr me mend mendimet e tij, pasi në një bisedë të shkurtër para kamares së kabinës së tij, më foli për diçka larg e larg.

— Jo, unë jam njeri i thjeshtë. Ju dini më shumë se unë, po dua të them që . . . Domethënë po vë re ca gjëra që nuk shkojnë . . . — dhe e futi kokën përsëri në kabinë, duke ndezur një cigare tjetër.

— Çfarë nuk shkon, Abdurahman? — pyeta unë.

— Jo, që të kam llafin, se ju dini më shumë se unë . . . — tha Abdurahmani dhe e

shkundi hirin e duhanit në tavllën e mbushur me bishta cigaresh.

Ai e kishte ulur kokën dhe shikonte diku në këmbët që nuk i dukeshin. E shihja që diçka e mundonte, por nuk e thoshte. Ju afrova kabinës dhe i thashë të dilte, të merrte pak ajër të pastër. Doli ngadalë dhe qëndroi krah meje në prakun e portës së madhe të institucionit tonë. Në këtë kohë hynë dy nga vajzat e reja që punonin te ne. Ato ishin të gëzuara dhe qeshnin me njëra-tjetrën. Fustanet e shkurtëra u vinin gjer mbi gju. Abdurahmani i pa me bisht të syrit, pastaj u buzëqeshi, duke i përshëndetur dhe m'u kthye përsëri.

— Jo, ju dini më shumë se unë, po i pe ato që hynë?

— I pashë! — u përgjegja.

— I pe, domethënë . . . — tha ai dhe psherëtiu.

Në rrugë kaloi një grup vajzash e djemsh studentë të fakultetit të shkencave të natyrës. Ata ecnin lirshëm, flisnin me zë të lartë dhe e shponin njëri-tjetrin me bërryl për t'ua tërhequr vëmendjen në bisedë.

— Edhe këto . . . Një lloj si ato të dyja! — tha Abdurahmani.

— E çfarë, Abdurahman? — pyeta unë.

— Ju, xhanëm, dini më shumë se unë.

Në këtë kohë kaloi Vangjushi, një djalë i ri, i gjatë dhe i pashëm. Ai kishte një vit që punonte në institutin tonë. Ishte njeri i shkathët dhe tepër serioz në punën e vet. Vangjushi më përshëndeti mua, pastaj Abdurahmanin.

— Lodhesh, Abdurahman? — tha ai.

— Pak, Vangjush, pak — tha Abdurahmani me një buzëqeshje të ngrirë në fytyrë e me mollëzat e faqeve të kuqe. Vërtet portieri ynë gjithënjë mollëzat e faqeve i ka të kuqe.

Abdurahmani u fut në kabinën e tij, e vendosi mirë jastëkun e hollë në karrige dhe u ul. Unë kalova pranë kabinës së tij dhe ngjita shkallët. Pas dëgjova një mumuritje të lehtë dhe fjalë të pakuptueshme që delnin nga kamara e vogël e portierit.

U ula në tryezë dhe mendja më shkoi te Abdurahmani. «Ndofta, thashë me vete, ai

mendon për gjëra që ne s'na shkojnë ndër mend për njerëzit e për sjelljen e tyre. Dreq, o Abdurahman! Dhe unë qesha me vetë.

Një ditë tjetër, tek zbrisja nga shkallët, pashë të qëndronin para kabinës së portierit dy djem të veshur mirë. Abdurahmani kishte në dorë receptorin e telefonit dhe sigurisht bisedonte me ndonjë nga nëpunësit e institucionit tonë, te i cili vinin ata dy djemtë.

— Të vijnë, shoku Vangjush? — pyeti ai po me atë buzëqeshje të ngrirë e po me ato mollëza të skuqura.

Djemtë filluan të ngjitnin shkallët, ndërsa portieri tundte kokën e fliste me vete.

— E di unë, e di! Tani, si të duan! . .

Unë kisha qëndruar në fund të shkallëve dhe shikoja portierin. Sytë e tij të vegjël lëviznin majtas e djathtas dhe mollëzat e faqeve skuqnin.

— Ç'ke, Abdurahman? — pyeta unë.

— Jo, ju dini më shumë se unë. Ç'jam unë? Një portier! Më fal që po të them. . . I pe ata dy djem?

— I pashë!

— Më thanë se duan të shkojnë te Vangjushi. E mora në telefon, Vangjushin. «Le të hyjnë», më tha. . . Le të hyjnë, xhanëm, s'kam ndonjë kundërshtim. . . — tha ai.

Nuk kuptoja asgjë. Mundohesha t'i zgjidhja gjithë ato fjalë që dolën nga kamarja e vogël, por nuk mund të merrja vesh asgjë. Ç'është e vërteta ndjeja një farë shqetësimi të Abdurahmanit, por nuk kuptoja se ku e kish burimin ky shqetësim.

— E çfarë? — pyeta unë.

— Unë jam njeri i thjeshtë, përgjegjësira nuk kam, por më duket se nuk venë punët mirë — tha ai në mënyrë evazive.

Këto fjalë bashkë me kureshtjen time më nxitën t'i afrohesha kabinës së tij. Ai më pa që u interesova dhe u ul në karrige, ndofta për të më bërë më kureshtar.

— Ku nuk venë mirë punët? — thashë unë.

— Jo, xhanëm, ne kemi përparime. Kombinate e fabrika ndërtojmë, hidrocentrale ngremë. . . Po ka ca gjera që. . . Tani ju e dini më mirë.

Unë nisa të nxehesha. Pastaj fillova të shaja veten që merresha me këtë njeri që i zvarrit fjalët dhe asgjë nuk thotë. Pa e kuptuar edhe vetë, dalëngadalë filloi të më push-tonte një mërzi, tek e shikoja në kabinë. E megjithatë, më shtynte kureshtja për të hyrë në shqetësimin e tij e për ta zbuluar burimin e këtij shqetësimi.

— I pe ata dy djem? — përsëriti ai.

— E? — pyeta.

— Ti kujton se shkojnë te Vangjushi? E marr me mend se ku venë! E di, dua të them... Tani ju keni shkollë, po... Mund të ngjasin edhe gjëra të papëlqyera — tha ai.

Mua më pushtoi trishtimi. E vështrova Abdurahmanin, por nuk i thashë gjë. Kapër-ceva prakun e portës sonë të madhe dhe dola në rrugë. Abdurahmani doli nga kabina, më ndoqi pas, më mbështeti dorën në krah dhe më tha ngadalë:

— Tani ju e dini... Mbase unë gaboj... Unë jam njeri i thjeshtë... Ju mund edhe të mos dëgjoni.

— Mirë, Abdurahman! — thashë dhe u ndava prej tij.

Në rrugë kalonin djem e vajza të qeshura. Rruga jonë ka shumë djem e vajza të qeshura. Por mua më zienin veshët nga fjalët e Abdurahmanit.

2.

Mendon Abdurahman Arbana në kabinë. Por kohët e fundit edhe ka filluar të shkruajë. Nxjerr një letër dhe herë pas here diçka shënon. Pastaj e fshin atë që ka shkruar dhe shënon përsëri. Kur kalon njeri, ai e fsheh letrën dhe rri drejt në karrigen e tij, duke u ankuar për mesin që ka filluar t'i dhembë. Ç'shkruan vallë? Unë e di se ç'shkruan, pasi njëherë e zura gafil, duke shënuar në letër dhe ai ma dha ta lexoja dhe m'u lut t'ja korigjoja.

— Tani, ju dini më shumë se unë, por mos ja trego njeriu këtë që do të lexosh. Merrre dhe korigjose në shtëpi. . . — tha ai duke ma zgjatur letrën.

E futa pa gjë të keq letrën në xhep, duke buzëqeshur. «Ka filluar të shkruajë vjersha

Abdurahmani»! thashë me vete dhe dola. Pra-
pa shpine ndjeva dorën e tij.

— Jo, unë nuk marr vesh shumë.
Unë jam njeri i thjeshtë, por kam menduar ca
gjëra me kokën time. . .

— Mirë, do ta lexoj — thashë unë dhe u
mata të ikja. Ai më ra pas e më hoqi nga kra-
hu.

— Dëgjo, kjo të mbetet mes tonë — tha
ai, duke i dhënë fytyrës një shprehje misterio-
ze, si të atyre njerëzve që fshehin një sekret të
madh.

Unë shpejtoja për në një mbledhje dhe
nuk kisha kohë ta lexoja shkrimin e tij. Në
mbledhje i harrova letrat në fund të xhepit
dhe vetëm në shtëpi, vonë pasdreke u kuj-
tova t'i lexoja. Gruaja dhe fëmijët kishin rënë
të flinin dhe në dhomë ishte qetësi. Atë natë
unë ndjeja një lehtësi në shpirt, se vajza ime
kishte mbaruar me nota të mira klasën e pa-
rë të tetëvjeçares. Me këtë ndjenjë të lehtë
e hapa edhe shkrimin e Abdurahmanit për të
qeshur pak me vjershat e tij. Por balli im u
rrudh dhe përnjëherësh më pushtoi një trish-

tim. Në krye të fletës së parë ishte shënuar: «Informacion» Pastaj: «Drejtorisë së Institucionit N. Për njoftim organizatës bazë të partisë dhe Komitetit të Partisë». Pastaj: Unë, i nënshkruari Abdurahman Arbana, portier i institucionit N. nën përgjegjësinë time personale, njoftoj si më poshtë vijon: Unë kam dhjetë vjet që punoj në këtë institucion. Detyrën e kam kryer me nder. Edhe të meta kam pasur, por me ndihmën e kolektivit i kam zhdukur. Si njeri i thjeshtë unë kam vënë re kohët e fundit se në institucionin tonë ka gjera që nuk venë, ka imoralitet, më falni për këtë fjalë. Në këtë drejtim ka imoralitet. Te vajzat të quajtura Shega dhe Elvira, nëpunëse në institucionin në fjalë, vijnë dy djem. Kodosh, më falni edhe për këtë fjalë, është bërë Vangjush Cilja. Këta dy djemë vijnë e kërkojnë Vangjushin, futën brenda me anën e tij dhe takohen me Shegën dhe Elvirën. Kjo nuk i ka hije moralit tonë. I kam parë njëherë këta dy djem që kanë qeshur në shkallë me Shegën dhe Elvirën. Kjo përsëri nuk është e hijshme. Mund të zbardhësh dhëmbët në një institucion

shtetëror? Në këtë drejtim nuk mund të zbardhësh dhëmbët! Edhe një sinjalizim tjetër. Vajzat të quajtura Shega dhe Elvira, kanë një veshje e mbathje të modës borgjeze. Fustanet i kanë dy gisht mbi gju, takat e sandaleve i kanë të trasha dhe të larta me lloj-lloj ngjyrash. Mbajnë rrypa e ku ta di unë, si të borgjezisë. Edhe në drejtim të flokëve kanë mbeturina borgjeze. Njërin sy e fshehin me flokët që i lëshojnë në gjysmën e fytyrës, si ato gratë që kemi parë në filma. Me sa jam informuar unë, njëra nga ato ka televizor dhe nga ky televizor kanë mësuar shumë gjëra të këqija, domethënë borgjeze. Në këtë drejtim mendoj të merren në shqyrtim nga ajo drejtori. Me nderime, Abdurahman Arbana».

E lexova letrën, e mbylla dhe e hodha në qoshe të tryezës. Çupa ime qeshte në gjumë. Unë ndeza një cigare e fillova të mendoja për Abdurahmanin, për «informacionin» e tij, për gjykimet e tij. Dhe papritur psherëtiva.

Abdurahman Arbana është mbështetur në tryezën e vogël të kabinës së tij, ka vënë dorën në faqe e mendon. Para meje kalojnë dy vajzat, Shega dhe Elvira. Ato ngjitin shpejt shkallët dhe fustanet e tyre lëviznin si dy krahë fluturë. Ai shikon vajzat i menduar dhe nuk më vë re mua. Kur më vë re, e heq dorën nga faqja dhe zgjat kokën nga kamarja e kabinës. Në xhepin tim rëndon «informacioni».

— E ma korigjuat? Tani ju i diin këto punë, unë jam njeri i thjeshtë! — thotë ai i drojtur.

Unë e vështrova dhe nuk flas për një çast.

— Apo nuk e kam shkruar mirë? — pyet ai dhe del nga kabina.

Qëndroj para tij i heshtur. Përtoj të flas. E fut dorën në xhep dhe ja jap shkrimin. Ai e merr dhe e hap. Nuk shikon asnjë ndryshim.

— Ti nuk e paske korigjuar! — pshe-rëtin Abdurahmani.

— Nuk e kam korigjuar, Abdurahman!
— i them.

— E kam shkruar mirë, domethënë —
buzëqesh ai duke vërtitur letrat në duar.

Mollëzat e kuqe të faqeve të tij fillojnë të formojnë nga një rreth të zbetë. Një zbetësi e tillë përhapet edhe në të dy anët e hundës, mbi buzën e sipërme. Sytë e vegjël shkëlqejnë dhe bëhen të rrumbullakët si dy kapsa.

Unë vazhdoj të qëndroj i heshtur me vështrim nga kamarja, ku duket koka e Abdurahmanit. Për një çast nuk e dalloj kokën e tij. Ajo shkrihet në sfondin e murit gri, i heq sytë nga kamarja, kthej krahët dhe matem të ngjit shkallët. Abdurahmani diçka murmurit si zakonisht. Unë shpejtoj hapin. Në shkallën e tretë ndjej se dikush më tërheq për mënge.

— Unë mund ta dorëzoj edhe të pakorigjuar, por thashë se do të ishte më mirë sikur të ma ndreqnit.

Ktheva kokën nga ai. Qëndronte një shkallë më poshtë se unë me letra në dorë. Për herë të parë vura re se maja e kokës së tij nuk kish flokë. Ç'është e vërteta, kishte flokë por i kish të imta, si push. Ai ngri-ti sytë e vegjël nga unë e buzëqeshi me një

drojtje të madhe. Përsëri, për herë të parë unë vura re se sytë e tij ishin pakëz të kuq dhe bebë të kaltëra, ose më mirë me një ngjyrë të papërcaktuar.

— Nuk më the, e kam shkruar mirë?
— pyeti ai po me atë buzëqeshje.

Unë nuk fola. E pashë me një vështrim tërë mërzi e bezdi. Ai e kuptoi dhe dora që mbante letrën u drodh. Për ta fshehur këtë dridhmë, e futi letrën në xhep dhe nuk e nxori andej dorën.

— E sheh? E dija që duhej korigjuar, prandaj ta dhashë, — tha ai.

— Nuk korigjohet, Abdurahman! — thashë unë dhe i dhashë të kuptonte se nuk kisha më dëshirë të rrija bashkë me atë në shkallë.

Atëhere ai heshti. Unë dëgjova se si kërciste në xhepin e tij letra e shkruar. Ai e trazonte me dorë. Nuk e dëgjoja dot këtë kërcitje letre.

Hodha një hap dhe fillova të ngjitja shkallët, që i kisha lënë përgjysmë.

Kisha arritur në krye të shkallëve, kur

ndjeva përsëri një prekje të lehtë në bërryl. Ai prekte vetëm me majat e dy gishtërinjve të dorës, prekte ngadalë-ngadalë. Përsëri nuk më ndahej! Kjo i shëmbëllente një ëndrre: ikën e nuk shkëputesh prej dikujt.

— Për të mirën e shtetit e bëra. . . Ju dini më shumë se unë. Jam njeri i thjeshtë e pa shkollë. . . Por janë ca gjëra që. . . — tha ai me kokë të hedhur prapa qafës ngaqë unë qëndroja dy shkallë më sipër prej tij?

— Shko, Abdurahman! — thashë unë dhe vazhdova të ecja.

Ai zbriti ngadalë shkallët dhe hyri përsëri në kabinën e tij. Diçka fliste me vete. . .

DY PORTRERE TË NJË FYTYRE

Piktori i ri kishte dëgjuar për bukuritë e bregdetit. Po ndryshe është t'i dëgjosh e ndryshe është t'i shohësh. Piktori i ri, që quhej Agim, ngado që hidhte sytë, zbulonte kënde pejsazhesh fantastike, aq sa i duke-shin ireale.

Agimi harronte të hante dhe drekë. Punonte e punonte ditë e javë, sa kishte mbushur dhjetëra fletë me skica dhe dhjetëra fletë e kartone me etyde ullinjsh të lashtë e fidanesh në bregore me tarraca, me dallgët që përplaseshin në shkëmbinj të thepisur dhe me valë të bardha në zallin e bardhë, me shtëpi të verdha mes gjelbërimit të thellë të portokalleve dhe njerëz në punë. Dhe i dukej, sikur akoma s'kishte filluar nga puna.

Kishte hyrë në një botë që buronte frymëzim dhe dëshirë për të punuar, për të pikturuar, për të paraqitur diçka nga jeta e ditëve të gjallërisë dhe të heroizmave. . .

«Edhe toka, sikur është hedhur në sulm. . . Edhe deti, sikur është hedhur në sulm. . . Edhe era, që loz me majat e qipariseve dhe me gjethet e ullinjve, sikur këndon për këtë kohë, për këtë epokë. . .» mendonte Agimi, kur çlodhej pakëz, duke kundruar me dashuri gjithë natyrën që e rrethonte.

Disa shokë ja kishin thënë që më parë që të kishte mendjen nga bregdetasit se ata janë hokatarë të dëgjuar, si detarët e vaporeve të mëdha. Këtë gjë Agimi e kishte vënë re në mensë, në klub, në mbledhjen e brigadave, në takimet e shumta që kishte me pleq e me të rinj. Ai kishte shfaqur dëshirën që të pikturonte tipin më interesant të fshatit, që të tipizonte rininë dinamike të kooperativës, e megjithëse i kishte parë të gjithë me radhë, ende nuk vendoste. Dhe ata i thoshin:

— Unë them të bësh portretin e brigadierit Janaq, që fle nën hijen e fikut.

— Më mirë është të na bëjë kryetarin tonë, që thotë se, pasi pi shumë ujë, trashet.

— Po! Atij edhe uji i bëhet gjak e dhjamë. . .

— Pse të mos bëjë përgjegjësen e çerdhes, e cila në vend të fëmijëve mban kllonçka!

Pak nga pak Agimi po hynte në jetën e gëzuar të njerëzve. Shumë fytyra i ishin bërë familjare, sidomos fytyra e Lefterit, i cili dallohej kudo edhe për punë, edhe për këngë, edhe për valle. . . Dhe Lefteri e kish kuptuar që Agimi i vinte rrotull për t'i bërë portretin, andaj, dhe kur e shihte, i shtrëngonte dorën dhe e pyeste se si i dukej jeta e fshatit. . . «Për pak vjet, kur të na vish prapë këtu, ke për të parë shumë ndryshime».

«Ky është personazhi tipik për mua. . .» mendonte Agimi. Dhe vendosi që t'ja bënte portretin. Këtë e shfaqti një mbrëmje në va-

trën e kulturës, ku fshatarët prisnin të shihnin televizorin.

Lefteri ishte i vetëdijshëm për punën që bënte. Dhe i vinte mirë kur përmendej në mbledhje dhe kudo si punëtor i dalluar dhe i dashur me të gjithë. Agimi, në shumë takime me të, e kishte pyetur se si e kishte organizuar jetën familjare, jetën në punë, jetën pas punës. Dhe Lefteri gjithnjë duke qeshur, i thoshte:

— Kemi shumë punë... kemi shumë punë... Po edhe pushojmë, edhe argëtohemi.

Agimi e vinte re se si i bënte gropat për fidana të reja, si punonte duke ngritur lëdhe, si ndihmonte shoqët dhe shokët e tjerë të brigadës. Dhe ai jo vetëm që bënte edhe dy norma në ditë, po në shumë raste (dhe kjo ngjante përditë) ai u jepte dorën kooperativistëve të tjerë në punët më të vështira. Agimi, e pa një ditë, kur ja rrëmbeu sëpatën një shoqeje, që priste një trung të thatë... dhe i tha: «Këto punë janë për ne burrat dhe jo për ty... Ti shko dhe transporto drutë e

prera. . .» Qëllonte Lefteri me sëpatë dhe trungu çahej, sikur të ishte prej hallve dhe jo trung rrapi, i kishte hije kur djersinte dhe kur skuqej më shumë. Trupi i tij gjithë muskuj ishte i mbushur dhe i harmonishëm. Agimi i vërente lëvizjet dhe shprehjen e fytyrës. Dhe gjithnjë skiconte e skiconte për të zbuluar çdo detaj për portretin që do të bënte.

Darkave, kur mblidheshin në klub apo në vatrën e kulturës, Lefteri tregonte edhe qyfyre. Dhe e gjallëronte atmosferën. Një shoqe e re ju afrua Agimit dhe i tha:

— Të pëlqen shumë Lefteri!

Agimi nuk dinte se si t'i përgjegjej. Qeshi dhe ngriti supet:

— Të gjithë më pëlqejnë.

— Ke vendosur që t'i bësh portretin, ë?

— Ashtu them.

— Për punë nuk e ka shokun. . . Po unë ju këshilloj t'i shkoni edhe një herë në familje për. . .

Agimi desh ta pyeste për diçka, po shoqja iku se e kërkoi një shok tjetër. Fjalët e saj kishin diçka që e bënë të mendojë Agimin.

Dhe ai në ato çaste parakaloi me sytë e mendimit gjithë skenat e aktivitetit dhe jetës së Lefterit në punë dhe jashtë saj.

— Ç'ke që mendohesh, shoku piktor? — i tha sekretari i organizatës bazë të partisë të fshatit.

Dhe Agimi, që e kishte njohur mirë, erdhi në vete, i shtrëngoi dorën dhe pastaj i tha mendimin e tij.

— Mirë, mirë. . . — i tha ai. — Shko dhe. . .

Agimi të nesërmen i vajti në shtëpi Lefterit. Aty gjeti dy pleqtë, babain, nënën dhe tre fëmijët e Lefterit. Ata e pritën mirë. Kishin dëgjuar se kishte ardhur një piktor, po ata nuk e kishin përfytyruar ashtu siç e shihnin tani, të ri, të thjeshtë, të sjellshëm dhe fjalëpak.

— Keni një djalë shumë të mirë — tha Agimi.

Plaku nuk ju përgjegj fare. Po plaka tha:

— I mirë është, si gjithë shokët e tij. . .

— Është shumë i dashur me të gjithë. . .

Është punëtor, i dalluar, është shtylla e brigadës. . . — tha Agimi.

Plaku pinte duhan dhe e shikonte në sy këtë piktor të ri, që i fliste kështu për Lefterin e tij. Dhe nuk ju përgjegj. Po plaku tha:

— I dashur dhe i mirë. . . ashtu si shokët e tij.

Agimi vërente shprehjen e qetë të plakut dhe desh të skiconte fytyrën e gdhendur nga era dhe nga puna të këtij fshatari që i ngjante gërxxhit në shi e gërxxhit në diell.

Piktori i ri, kërkoi të shikonte gjithë dhomat e shtëpisë, se desh të dinte ku hante dhe ku flinte Lefteri. Pastaj me plakun dolën në breg nga dukej gjithë fshati dhe poshtë deti i pakufishëm. Plaku i tregonte Agimit për të kaluarën, për kurbetet, për varfërinë, për mjerimin. . . për tokën dhe hapte krahët, duke i treguar bregoret dhe luginat që gjelbëronin.

— Tani dhe toka qesh. . . Dhe, kur qesh toka, gëzimi mbin në çdo vatër, në çdo shpirt... Ashtu, — dhe shikonte tarracat e reja dhe kanalet e reja, shikonte pllajat e gjelbërta dhe humbte në heshtje e piktori vërente ata sy

të thellë dhe të ndritur, atë shprehje njerëzore, të qetë.

— Dhe Lefteri është njeri nga ata që mbolli gëzimin në tokë. . . — tha Agimi.

— Ashtu është — i tha plaku dhe i hodhi një shikim të shpejtë. — Po gëzimin njeriu duhet ta mbajë edhe për vatrën e tij. — Dhe heshti, si ai që pendohet për atë që tha.

— Patjetër. Vatra është llogorja e vruilit për gëzime, për punë dhe për heroizma.

Plaku nuk e kuptoi apo nuk e dëgjoi fare, këtë nuk e vuri re Agimi.

— Se, — tha plaku — se, që thua ti, mor bir, njeriu i mirë, njeriu i Partisë, njeriu që do Enver Hoxhën është ai që. . .

Piktori vuri re se shprehja e plakut kishte marrë pamjen e gërxhit në shi.

— . . . është ai që gëzimin nuk e derdh vetëm në punë, në klube e në shoqëri. . . po e mban dhe për vatrën e tij, për gruan e tij, për kalamanët e tij, për pleqtë e tij. . . — Heshti një copë herë. E pa në sy Agimin dhe e pyeti: — Nuk është kështu?

— Kështu është — tha Agimi?

Pastaj folën për të kaluarën, për të sotmen dhe për të nesërmen.

Plaku nuk e la të ikte. E mbajti për drekë. E mbajti gjersa erdhi edhe Lefteri nga puna. Pas pak erdhi dhe e shoqja e Lefterit. U gëzua që e gjeti aty piktorin e ri. Dhe fëmijët u gëzuan.

Tani Agimi vinte re se Lefteri nuk ishte ai Lefter që kishte njohur në punë, në klub e në vatrën e kulturës. Lefteri rrinte si i ngrysur dhe nuk ja kthente sytë kurrë as plakut, as plakës dhe as gruas së tij. Edhe fëmijët nuk i afroheshin. E shikonin me sy të ftohtë.

— A dalim? — i tha Lefteri Agimit. Plaku uli kokën.

— Pse të dilni? — tha gruaja e Lefterit. — Duam ta njohim edhe ne piktorin.

— Kush të pyeti ty? — i tha Lefteri pa e shikuar fare. — Dalim, shoku Agim! — dhe u ngrit. Plaku nuk lëvizi as qepallat, kushedi se ku kishte shkuar. Mbase nuk dëshironte të ishte fare aty.

Agimi, desh, s'desh, u ngrit, se e priste më këmbë Lefteri. Dolën. Dhe ecën ca pa fo-

lur fare. Pastaj Lefteri e pyeti se si e kishte kaluar ditën dhe si i dukej fshati. Dhe, duke biseduar, fjalën e pruri aty ku desh:

— Ë, si vendose?

— Dua të të bëj portretin.

Dhe shumë ditë pas punë Lefteri shkonte në shkollë, se aty e priste Agimi që po punonte për portretin e tij. Lefteri kishte dëshirë ta shihte sa më parë veprën e piktorit të ri.

Agimi shkonte përsëri në punë dhe e shihte Lefterin. E shihte të gëzuar, dinamik, duke bërë shakara me shoqe dhe me brigadieren, me të cilën shkëmbente shikime që flisnin. Aty Agimit i kujtoheshin fjalët e plakut: «Njeriu i mirë, njeriu i Partisë, njeriu i punës, njeriu që do Enver Hoxhën, është ai njeri që gëzimin nuk e derdh vetëm në punë e në klube, po e derdh më parë në familjen e tij, në fëmijët e tij, për të cilët punon. . .»

. . . Pa erdhi dhe dita që priste me padurim Lefteri. Atë mbrëmje do të ekspozohej portreti i tij në vatrën e kulturës. Ishin mbledhur shumë të rinj e të reja. Ishin aty dhe arsimtarët dhe udhëheqësit e kooperativës buj-

qësore. Të gjithë shikonin portretin e mbuluar me një çarçaf të madh. Pritën sa u mbush gjithë salla. Pastaj filluan të pëshpëritnin: «Duam ta shohim, duam ta shohim». Lefteri fluturonte nga gëzimi.

— Po kush do ta zbulojë?

Disa thanë ta zbulonte sekretari i organizatës bazë, disa thanë ta zbulonte kryetari i kooperativës, disa thanë ta zbulonte brigadierja, po shumë të reja thirrën:

— Lefteri, Lefteri! Lefteri ta zbulojë vetë.

Të gjithë qenë të një mendimi: Lefteri ta zbulonte.

— Shko, Lefter! — i tha brigadierja që priste me ankth të shihte punëtorin më të dalluar të brigadës.

Lefteri hodhi hapat e parë. U afrua. Zgjati dorën për të hequr çarçafin. Cilido shtyhej për të dalë në ballë. Lefteri e hoqi dhe. . . dhe papritur një «uah!» i zgjatur gumëzhiti në sallë. Lefterit i mbeti çarçafi në dorë, se nuk e kuptoi këtë «uah» se ç'ishte, tallje apo admirim. . . Duke tërhequr çarçafin, u largua

për ta parë më mirë portretin e tij, për të cilin shumë vajza zunë të qeshnin.

E pa me kujdes. Piktori e kishte bërë në dy portrete. Në të parin ishte Lefteri në punë: i gëzuar, i qeshur, i vrullshëm, sulmues. . . Në të dytin e kishte bërë në familje: të ngrysur, të egër, të mërzitur, despot.

Ra një heshtje e madhe. Lefteri mbeti i ngrirë.

— E, Lefter, si të duket?

Lefteri e dëgjoi këtë zë që ju duk si zëri i sekretarit të organizatës bazë të fshatit, po nuk ktheu kokën për ta parë.

Ju afrua Agimi dhe e pyeti:

— Si të duket, shoku Lefter?

Lefteri e pa në sy. Buzëqeshi me zor dhe ju përgjegj:

— Ashtu është!

— Po nuk duhet të jetë kështu! — i tha dikush.

Lefteri e dëgjoi këtë zë që ju duk si zëri i sekretarit të organizatës bazë të fshatit, po nuk ktheu kokën për ta parë.

— Ashtu është! — përsëriti Lefteri.

NJË NATE PA DRITË

Mbrëmja ra e qetë dhe e plogësht. Mjegulla u ngrit nga fusha e zezë dhe ngadalë filloi t'i ngjitej malit si e ndjellur nga çatitë e gurtat të qytetit. Doktor Thomai tërhoqi me kujdes derën prej xhami të sallës së operacionit dhe doli në korridorin e vogël e të ngushtë. Si bëri disa hapa, qëndroi dhe mbajti vesh duke mbledhur buzët. «S'i ka dalë akoma naragoza». Nga dera përballë hyri infermieri.

— Kije një çikë kujdes të operuarin. Unë po shkoj — foli Thomai.

— Natën e mirë, doktor! — tha infermieri.

Doktori doli në rrugë. Ngriti jakën e palltos dhe vështroi nga qyteti i vogël në faqen e malit, dritat e të cilit mezi shquheshin

nga mjegulla. Një radhë dritash, me një largësi të barabartë, po në mënyrë të çrregullt, ngjiteshin rrugës së dredhur gjer në qendër ku shquheshin dritaret e shumta të hotelit të ri.

«Shpëtoi, foli me vete doktori për të porsaoperuarin, shpëtoi për çudi. Do të kthehem të pi një gotë, pastaj të shkoj në shtëpi».

Dritarja e pijetores ndriçonte dobët. Gjithë rruga e ngushtë dhe e shtrembër mban-te erë mishi të pjekur. Nga dera e pijetores dilte tym.

«S'do të ketë vend», mendoi mjeku dhe ngadalësoi të ecurit. Kur ju afrua derës së pijetores, dëgjoi ta thërrisnin. Mjeku ktheu kokën, po s'mundi ta dallonte fytyrën e atij që e thirri. Ai po i afrohej me nxitim dhe dukej si një njollë e zezë e lëvizshme.

— Ç'është? — pyeti mjeku.

Njeriu që e thirri e kuptoi se doktori do të pinte dhe mbeti.

— Folë, — tha mjeku — folë, ç'ke?

— Ju po shkoni të pini.

— Po, — tha mjeku — pse?

— Kam sjellë gruan në spital, infermieri dhe ndihmësmjeku u trembën kur e panë dhe më thanë t'ju thërrisja ju. Ju lutem, doktor!

— Ç'ka gruaja? — pyeti mjeku.

— I pret barku, sikur i ngulin thika, — tha burri — mbase duhet të operohet. Unë e kam sjellë edhe një herë tjetër te ju, para një viti.

— E ç'të thashë atëhere?

— «Ta operojmë,» thatë, po unë kisha frikë.

Mjeku diç murmuriti nëpër dhëmbë dhe u kthye. Në qoshe të rrugës ata muarën në të majtë, zbritën poshtë e humbën në rrugën që të çonte për në spital.

* * *

Vetëm kur pa të sëmurën, doktori harroi inatin që kishte pasur gjatë gjithë rrugës për burrin që, para një viti s'kishte pranuar të operonte të shoqen. Ajo kishte kafshuar aq shumë buzët nga dhembja, saqë doktori pa shenja gjaku në to, megjithëse infer-

mieri ja kishte fshirë. Si e vizitoi me kujdes, dha urdhër që të bëheshin gati për operacion.

— Ju, — u tha doktori fshatarit dhe dy fëmijëve — dilni përjashta.

Pas dhjetë minutash në sallën e operacionit gjithshka ishte gati. Ora donte dhe pesë minuta të shkonte tetë. Përjashta ishte errur shumë. Pas dritareve të sallës së operacionit doktori vuri re disa hije.

«Do të jenë ata», mendoi dhe urdhëroi që t'i largonin së andejmi.

— Fillojmë — tha dhe pa orën.

Drita e sallës së operacionit ndriçonte mbi rrobot e bardha të mjekut, asistentit dhe infermieres. Duke operuar, mjeku kujtoi të shoqin e së sëmurës dhe dy fëmijët që rrinin e vështronin përjashta dhe i erdhi keq që u soll ashpër me ta.

— Më jep bisturinë — tha ai pasi bëri lidhjen e apendiksit.

Gruaja rënkoj.

— Shpëtove — pëshpëriti mjeku me një ton aq të qetë, sa asistentit dhe infermieres u bëri përshtypje.

— Ja, tashti do të fillojmë të qepim, dhe pas pak do të çlodhesh në krevat.

Asistenti dhe infermierja panë në të njëjtën kohë mjekun, pastaj u vështruan sy më sy të trembur. Mjeku s'e kuptoi heshtjen dhe ngathësinë e tyre.

— Ç'keni — foli mjeku.

— Asgjë — tha asistenti. — Jeni shumë i lodhur, doktor.

— Po, më lodhi ai — tha mjeku pa qenë nevoja të sqaronte. Ata e dinin se operacioni që kishin bërë pak më parë kishte zgjatur katër orë.

Gruaja përsëri rënkoi.

«Po i kalon narkoza», mendoi mjeku dhe u mundua të shpejtonte. Ngadalë ngriti kokën dhe pa orën. U vrejti dhe psherëtiu. Në çast ndjeu nevojën të hiqte maskën, e cila sikur e pengonte të merrte frymë lirisht. Duke mos vështruar nga asistenti, ngriti përsëri kokën për të parë orën dhe shtangu. Drita filloi të dobësohej. Mjeku puliti sytë, si për të përzënë lodhjen, që i kishte dobësuar vështrimin, po më kot. Drita ishte dobësuar vërtet dhe va-

zhdonte të dobësohej ngadalë, të tretej tamam si njeriu, që është duke vdekur.

Asistenti dhe infermierja ngritën kryet për të vështruar mjekun, po papritur, si fantazmë ra errësira. Mjeku u drodh dhe vështroi jashtë ku dalloi vetëm kryqet e vogla që formonin pjesët metalike të dritares.

— Dritë, dritë! — thirri sa salla e vogël e operacionit gjëmoi.

Asistenti dhe infermierja mbetën të ngrirë. E sëmura, e mbuluar me çarçafin e bardhë, dukej si një kufomë e akullt. E gjithë salla me dritën e dobët të natës që merrte nga dritaret, të kujtonte një shpellë të ftohtë polare, pa gjallëri, pa jetë.

— Dritë! — thirri përsëri mjeku, duke ngritur lart e larg njëra — tjetrës dy duart e përgjakura që në errësirë dukeshin të zeza, e me hap të madh u sul drejt derës së sallës së operacionit, që i ra me shqelm.

— Dritë! — thirri përsëri. Zëri i tij u përzie me zhurmën e ftohtë e të hollë të xhamit që u thye.

Të alarmuar e të hutuar u futën në pa-

radhomë pastruesja, dy infermierë dhe shoferi i autoambulancës.

— Ndize shpejt maqinën dhe drejtoi dritat në dritaret e sallës së operacionit. Shpejt, shpejt të them! Ç'rri si hu! — klithi mjeku.

Shoferi u zhduk. Njëra nga infermieret u largua e hutuar dhe pas pak solli elektrikun e dorës.

— Ndriço këtu — i tha mjeku asistentit.

Drita e elektrikut të dorës, e cila herë ndizej e herë dobësohej, mezi e ndriçonte barakun e hapur. Mjeku punonte më shumë me hamendje. Infermieres i mbeti koka nga dritarja. «Sa shumë që u vonua ky,» tha me vete për shoferin. Pas pak, të gjithë ata që ishin në sallën e operacionit, vështruan përjashta dritat e maqinës, që po rrotullohej për t'ju drejtuar dritareve.

Ajo, mjeku dhe asistenti, dëgjuan zhurmën e maqinës që uturonte. Mjeku e ndjente se sa vështirë e kishte shoferi të kthente maqinën drejt dritareve të sallës. Vendi aty ishte aq i ngushtë, sa shoferit, për të bërë kthesën, do t'i duhej të ecte para dhe prapa shumë he-

rë. Vetëm kështu, me zor ai mund të fitonte disa centimetra vend për të bërë kthesën. Mjeku nuk mund të operonte më. Zhurma e maqinës i buçiste në vesh. Të gjithë ndërpre- në punën dhe vështruan përjashta se si përpi- qej maqina sa majtas — djathtas, sa para — prapa.

E sëmura rënkoj:

— Ja, ja, tashti — u mundua ta qetë- sonte infermierja dhe ju afrua gruas te koka.

Tri hije të zeza, të tre njerëzve që pris- nin përjashta, kaluan nëpër sallën e operacio- nit si tri hije gjigante. Doktorin u drodh nga hijet që lëvizën nëpër sallë. Pas pak maqina me dy dritat e mëdha e të fuqishme, si dy sy të zjarrtë, qëndroi përballë. E tërë salla u ndri- çua si të kishin lindur përnjëherësh dy diej të vegjël kastile për gruan e për mjekun. Në fa- qen e murit përballë, katrorët metalikë të dri- tares dukeshin jo si kryqe të vogla, po si skela, tamam si ato skelat që u ngritën për hotelin e ri në faqen e malit.

— O, sa u tremba, — tha mjeku — pandeva se çdo gjë mbaroi! — Doktorin vuri re

katër qepjet që kishte bërë me baterinë e dorës, vuri buzën në gaz dhe vazhdoi të qepte.

— Njeriu nuk duhet të thotë «hop» para se të kapërcejë hendekun — pëshpëriti dhe heshti.

Asistenti, i cili e njihte mirë, kuptoi se mjeku e ndjente veten të lumtur. Ai e dinte që vetëm në të tilla raste të rralla doktori thoshte ndonjë fjalë të urtë dhe vetëm kaq. Ai bëhej përsëri i heshtur e i ngrysur. Lumturia ose gëzimi i punës së mbaruar tek ai nuk zgjatnin shumë, sepse përnjëherësh fillonte puna e re. Dhe ai hipte e zbriste rrugën që lidhte spitalin me qytetin e vogël, me kantierin përtej urës, me lokalitetin matanë fushës, e me repartin ushtarak buzë përroit.

Doktori përfundoi edhe qepjen e fundit dhe hodhi në enën që kishte përkrah veglën e fundit, hoqi dorezat dhe i flaku në legen, hoqi maskën dhe mori frymë lirisht, duke ju afëruar dritares, po dritat e maqinës ja vranë sytë.

— Çojeni në dhomën nr. 3 — dha urdhër, duke u zhveshur.

Në korridorin që ndriçohej dobët nga

llambat e vajgurit takoi të shoqin e gruas. Ai mezi qëndronte në këmbë.

— Shpëtoi — i tha mjeku, dhe doli në rrugë. Ngriti jakën e palltos dhe vështroi qytetin, që dukej si fshat në faqen e malit të mbuluar me mjegull. Tek — tuk arrinin shumë dobët disa njolla drite.

— Doktor! — dëgjoj ai ta thërrisnin.

Doktori qëndroi, u kthye ngadalë dhe njohu burrin e së sëmurës.

— E pashë — i tha ai mjekut. — E pashë, ajo më foli, më tha se tashti s'i dhemb më barku.

— Shpëtoi — përsëriti mjeku duke ndjerë një gëzim të brendshëm në tonin, me të cilin foli fshatari.

— Unë të ktheva nga pijetorja, shkojmë pimë nga një gotë bashkë! — propozoi fshatari.

— Shkojmë, — tha mjeku — megjithëse u bë vonë.

Të dy, pranë njëri — tjetrit, morën të përpjetën. Doktorin ktheu kokën dhe pa dy dritat e fuqishme të maqinës që ende ndriçonin sallën e operacionit.

NUSJA E SHTEPISË

Mit Kola u kthye në shtëpi i menduar dhe i tronditur. As ja kishte marrë mendja se mund të ndodhte diçka e tillë.

«Si është e mundur?» pyeste veten, duke e ndjerë thellë dëshpërimin si një gjë të lëngshme që i kishte pushtuar gjithë pjesët e trupit dhe e shtrëngonte në grykë dhe në nofulla. Pështymën, sidomos, e ndjente të hidhur. Thuajse gjithë rrugës, që nga Lushnja e deri në fshat, cigaret i pat ndezur njërën pas tjetrës, po këtë e kishte bërë në mënyrë mekanike, nga dëshira që të merrej me diçka dhe jo se ndjente nevojë të pinte. Asnjëherë tjetër s'e kishte provuar këtë gjendje.

Nga pazari kishte ikur herët, pa blerë asgjë nga ato që kishte ndër mend të blinte e

pa e biseduar si zakonisht me miqtë e tij atë çështjen e koklavitur të të birit, për të cilën ai shkonte posaçërisht çdo të djelë në qytet.

— Si u bë kështu kjo punë? — tha me zë të lartë duke marrë frymë thellë dhe duke e nxjerrë ajrin me zhurmë. — Nusja s'paska pasur faj! Kujt ja merrte mendja?

Mit Kola hoqi këpucët dhe u ul në minder. Në shtëpi s'kishte asnjeri. Nga sa dukej, Sena do të kishte shkuar te fqinjët, kurse Stasi kthehej vonë në mbrëmje, se ishte kohë fushate. Miti i hodhi një sy dhomës rreth e qark, sikur po e shikonte pas një mungese të gjatë, dhe ndjeu se ajo nuk e kishte më atë hijeshi e atë pamje feste që kishte pasur dikur, atëhere kur nusja e Stasit ishte akoma në shtëpinë e tyre. Katja ja ndërroi pamjen dhomës që javën e parë. Nëpër dritare vuiri perde basme, në mure qëndizma dhe mobiljeve ua ndryshoi vendin. Atëhere çdo gjë dukej sikur ndriste e shkëlqente si dhëmbët e bardhë të Kates. Me të ikur nusja, Sena ca nga ca i ktheu të gjitha plaçkat në vendet e tyre të vjetra, se ashtu qe mësuar dhe i vinte

më lehtë dhe shtëpia mori sërish pamjen e saj të parë, të zyrtë dhe të rëndë.

Mit Kola ishte bërë shkak që djali ta ndante nusen. Dhe kurdoherë i kishte dhënë të drejtë vetes. Si mund të mbante në shtëpi një nuse që s'pillete, aq më tepër kur djalin e kish të vetëm? Mos vallë ish dënuar të ikte nga kjo botë buzëplasar, i dëshiruar për një fëmijë, duke menduar se trangu i lashtë i gjyshëve të tij do të merrte fund tek i biri dhe pastaj dera do të mbyllej dhe shtëpia do t'i shuhej? Mbi baltën e truallit të tij do të shkelnin gjurmë këmbësh të huaja dhe kopshtin do ta punonin duar të tjera. . Kur e mendonte këtë gjë, ngjethej dhe i sëmbonte zemra.

Ai e dinte fjalën e pleqve se peri këputet atje ku është më i hollë, dhe për këtë arsye ishte nxituar ta martonte djalin e vetëm sa më parë. Edhe të afërmit, edhe gjithë njerëzit që ja donin të mirën ashtu e këshilluan. Stasin e martuan sapo u kthye nga ushtria. Dhe, kur djemtë kthehen nga shërbimi ushtarak, nuk është aspak vështirë t'i martosh.

Në dasmë njerëzit hëngrën e pinë, ngri-

tën shëndete e dollari, dhe me fytyra të çelura i drejtoheshin të zotit të shtëpisë duke e uruar t'i trashëgohej djali e me gëzime të tjera.

Mit Kola kështu e kishte përfytyruar martesën e të birit; një festë të gëzuar dhe, pas saj, një varg fëmijësh që bënë kollotumba nëpër dysheqet dhe në dysheme. Edhe pleqërinë nuk e përfytyronte dot pa një fëmijë në pëqi. I dukej se e shikonte veten të ulur te praku i portës pasdrekeve vonë ose në mbrëmje, me një fëmijë në prehër duke bërë muhabet me kalimtarët, ndërsa njomëzaku gugaste duke luajtur njëherësh duar e këmbë. Pastaj i vogli i lagte prehërin dhe Miti ngrihej në këmbë e shkundej; kjo gjë i dukej atij si kulmi i pleqërisë së mbarë dhe të begatshme.

Viti i parë dhe i dytë kaluan në një pritje të heshtur e shpresëplotë. Babai i hidhte ndo një fjalë nuses së re, teksa ajo i shtinte ujë pranë pusit, duke shpresuar javë për javë të dëgjonte lajmin e bukur se ata kishin nisur një fëmijë. E njëjta gjë ndodhte edhe kur vinin njerëz për vizitë dhe uronin në mënyrë for-

male: «Epo, gëzuar! Me ndonjë djalë të Stasit tashti!

— Ju lumtë goja? — ua kthente Miti e me një qërtim të lehtë kthente vështrimin nga nusja.

Faqet e nuses bëheshin trëndafil dhe ajo ulte kokën.

Më vonë, bisedat për fëmijën që s'po vinte u bënë të përditshme dhe si Miti, ashtu edhe e shoqja, filluan ta shprehnin pakënaqësinë hapur. Mos vallë nusja e tyre s'bënte fëmijë?

Njëherë, kur kaloi në fshat një ekip shëndetësor aty nga viti 1955, e shpunë edhe te doktori. Ai i dha disa hape e disa gjëlpëra, por edhe ato nuk sollën gjë të re.

Atmosfera në familje u rëndua me mërzi e grindje të përhershme. Sena vinte rrotull nëpër oborr dhe murmuriste.

— Ishim dy pleq, tani u bëmë katër!

Katja, duke e ndjerë dobësinë e saj, përpiquej të ishte e rregullt dhe u shërbente pleqve si asnjë nuse tjetër, që të zbuste sadopak zemërimin dhe pakënaqësinë e tyre.

Mitit ndonjëherë i vinte keq për të renë dhe sikur pezmatohet nga fjalët e rënda që lëshonte Sena. Ajo e shante duke i thënë shterpë, e akuzonte se po i mbyllte derën dhe mallëkonte ditën kur nusja shkeli prakun e shtëpisë së tyre.

«Nusja na ka qëlluar beronjë, përsëriste shpesh Sena, nga ajo s'kemi ç'të presim më. Sa më parë ta ndajmë aq më mirë, në duam të na gëzohet shtëpia me fëmijë».

Presioni i prindërve e hepoi pa ndonjë vështirësi karakterin e lëkundshëm të Stasit. Ai njeri ishte shumë i mbyllur, disi apatik dhe s'kuptohej nëse kishte ndonjë ndjenjë dashurie për të shoqen.

Martesa u zgjidh po aq shpejt sa ç'ishte lidhur. U dërguan lajm vëllezërve të nuses që të vinin e ta merrnin të motrën dhe ata erdhën menjëherë. Duket, e dinin se motra e tyre vuante, se e pranuan si një gjë krejt të natyrshme ndarjen e saj, meqënëse s'bënte fëmijë.

— Ne do të na ishte nxirë faqja, sikur motra të na kish bërë ndonjë turp, pa për gjë-

ra që s'i kemi në dorë, s'kemi ç'bëjmë.

Fjalët e tyre Mitit ju dukën si një qërtim i rëndë. «Ta marrë djalli këtë punë, truajt me mend, ndërsa ata po nxirrnin teshat në oborr, po sikur të kishte lindur fëmijë dhe të mos i kishin rrojtur, ç'do të kishim bërë? A nuk do të ishte njëlloj? Ku i dihet jetës?»

Në ato çaste ishte gati t'u lutej krushqve ta linin nusen në shtëpi dhe të merrte fund njëherë e mirë ajo punë. Sena e nuhati lëkundjen e Mitit dhe i bëri me dorë një shenjë që kishte kuptimin: «Lëri të ikin, të këputin qafën!»

Kështu nusja iku nga shtëpia, pa thënë ndonjë fjalë, pa u ankuar, po duke e ndjerë veten të fyer e të poshtëruar si asnjëherë tjetër në jetë.

Plaçkat sikur ishin fijet e fundit të lidhjeve me nusen. Boshllëku në shtëpi u bë menjëherë më i madh e më i ndjeshëm.

Pastaj çdo gjë sikur u kthye si një film që shpëstillet së prapi. Më vonë, rastësisht, mësuan se nusja e tyre ishte martuar në Di-

vjakë me një burrë të ndarë, po ky lajm s'u bëri asnjë përshtypje.

Disa nga miqtë e tij dhe sekretari i partisë e kritikuan ashpër për atë veprim. Mit Kola i dëgjonte i përvuajtur pa u përpjekur t'i kundërshtonte dhe i prapësoi të gjitha sulmet me një taktikë të çuditshme. Ndërsa të tjerët e kritikonin, ai i dëgjonte i heshtur, pa u munduar të justifikohet, pa i kundërshtuar mendimet e tyre. Dhe heshtjen e tij njerëzit e kuptonin sipas shijeve që kishin. Disa e merrnin si të penduar dhe atëhere u dukej pa kuptim të vazhdonin ta qërtonin, dhe disa të tjerë si të hutuar.

Mit Kola nuk e zgjodhi këtë taktikë sipas një plani të caktuar, po ai vërtet, pas ikjes së Kates, nuk dinte të thoshte me saktësi nëse ishte sjellë ashtu si ja kërkonte mosha dhe nderi i shtëpisë.

Gjithë merakun tani e kishte te Stasi; atij sikur s'po i mbushej mendja të martohej së dyti, kundër parashikimeve të Mitit, po tregohej shumë i ngathët. Ai që fare i ri, shumë nga moshatarët e tij nuk ishin martuar en-

de, po ndarja nga e shoqja e kishte topitur dhe vazhdimisht fytyra e Stasit ruante një shprehje të pezmatuar.

Kur kishte qënë i vogël, qe sëmurrur shpesh dhe askush s'e dinte me saktësi sa sëmundje pat hequr. Derisa qe bërë pesë vjeç, mezi ishte ngritur në këmbë, po kjo qe një gjë e zakonshme për fëmijët myzeqarë, të cilët tok me qumështin e nënës thithnin edhe erën e molepsur të moçaleve. Jeta e tyre qe rrethuar me një re mushkonjash dhe ato, si bashkudhëtare të mërzitshme, i shoqëronin nga lindja gjer në vdekje. Dhe s'dihej nëse në gjakun e tyre kishte më shumë ruaza të kuqe apo vezë mushkonjash.

Ato mallëkonin moçalet ku kishin folenë retë e konupeve dhe tregonin legjenda se si njëherë ajo tokë kishte qënë fushë e tharë dhe e mirë, po një vajzë nga gëzimi që po kthehej i vëllai nga ushtria pas shtatë vjetësh, nga gëzimi e nga nxitimi për ta takuar, kishte harruar çesmat hapur dhe uji kishte mbuluar çdo gjë, fushën, fshatin dhe pendët.

Askujt s'ja merrte mendja se do të vinte

një ditë e fusha do të bonifikohet, fusha do të bëhet përsëri e thatë dhe toka pjellore, ashtu siç kishte qenë në ëndrrat e tyre. Ujërat e zeza dhe mushkonjat ishin zhdukur, po gjurmët e asaj kohe ndiheshin në jetën e tyre si një jehonë e largët. Ata s'donin ta kujtonin atë kohë, kurse ajo i kujtonte.

Miti shpresonte se gjendja e Stasit do të ndryshonte sapo në prakun e shtëpisë së tyre të hynte nusja e dytë, atëhere pezmatimi do të zhdukej nga fytyra e të birit dhe shtëpia do të mbushej me një gaz të ri, e sigurisht edhe me fëmijë të vegjël. Për këtë shkak ai shkonte javë për javë në pazarin e Lushnjës, takohej me miqtë dhe me të njohurit, sepse tani vetëm me anë miqësie shpresonte ta mbaronte atë punë. Veçse, kohët për mblerësitë po bëheshin të vështira. Këtë e kishte ndjerë edhe Mit Kola, tek bisedonte me miqtë e tij kokë më kokë në ndonjë qoshe klubi me filxhanët e kafesë përpara.

Atë të diel, Miti, para se të shkonte në kafe, kishte takuar një të njohur nga Divjaka. Ai i qe afruar, i kishte zgjatur një dorë të vakur

dhe me një buzëqeshje të shtirur i kishte thënë:

— E ke marrë vesh apo jo? Nusja juaj bëri një fëmijë këto ditë.

Miti s'kuptoi asgjë nga fjalët e bashkëbiseduesit.

— Çfarë thua se s'po të marr vesh? Cila nuse?

— E re, nusja juaj, ajo që e ndatë se s'bënte fëmijë. Në fshatin tonë polli! — Dhe ai qeshi përsëri me djallëzi.

Mit Kola e hetoi me sy nëse ai kishte ndër mend të bënte ndonjë shaka e të tallej kot së koti.

— Të betohem, për kokën e fëmijëve! — shtoi ai këtë herë serioz. — Mos jemi në moshë për të bërë shaka?

— Ah! — i shpëtoi Mitit padashur kjo thirrje nga gjoksi. — Si kështu?

Ai s'donte ta besonte dhe nga ana tjetër i dukej fare e pakuptueshme. Si kishte mundësi të ngjiste një diçka e tillë? Ndjente se përbrenda e gërryente inati si të kishte humbur një gjë shumë të çmuar nga një pakujdesi e vo-

gël dhe e rastit. Ja, pikërisht atij fëmije që po i gëzohej një gjysh tjetër, do t'i qe gëzuar ai vetë, sikur të kishte pasur durim edhe dy vjet. Pse s'kishte pritur, pse s'kishte duruar pak më gjatë?

— Po si kështu, e marrtë e mira! —
trujti me mllëf. — Ajo s'ndeji pak e ca në truallin tim. I thonë pesë vjet martesë me burrin pranë. Të kishte për të lindur, pse s'lindi atje?

— Po mund ta ketë pasur fajin edhe djali. . .

— Si? — pyeti Mit Kola, duke u kthyer menjëherë në drejtim të mikut nga Divjaka, saqë ai u tremb.

— Ngjet — tha ai ngadalë dhe, që t'i mbushte mendjen më mirë, i përmendi edhe nja dy raste të tjera.

Miti u hutua sepse një gjë të tillë s'e kishte dëgjuar kurrë. Në qoftë se ishte vërtet ashtu, atëhere nusen e kishte ngarkuar me faj kot së koti dhe e kishte dënuar pa të drejtë. Ndjeu sikur barrakat e pazarit u hepuan dhe ndërtesat luajtën nga vendi. Pemët dhe

gurët e kalldrëmit filluan të vinin rrotull dhe Miti mbylli sytë e vuri dorën mbi ballë që të mos i shikonte. Mollëzat e gishtërinjve ju lagën prej djersës. Hoqi takijen dhe fshiu qafën. Duke dashur ta mblidhte veten e ta fillonte çështjen me nge, kishte marrë rrugën i vetëm për në fshat.

— Kështu do të ketë qenë, — tha Miti me zë të lartë teksa rrinte në minder — fajin do ta ketë pasur Stasi.

Ai shkoi nëpër mend vjetët që kish kaluar me nusen në shtëpi dhe ata ju dukën si vjetët më të bukur të jetës së tij. Katja punonte gjithë ditën në fushat e kooperativës, por, përpara se të ikte nga shtëpia, çdo gjë e linte në rregull. Dhe të gjithëve u rrinte me buzë në gaz. Nga gjithë fytyra e saj Mitit atë çast ju kujtuan vëthët që i vareshin në bulëzat e veshëve e që tundeshin sa herë që lëvizte dorën ku mbante fshesën, kurse fytyra e saj sikur ishte mjegulluar e tretur tej.

Miti zgjati dorën; mori kotruven dhe e ngriti përperjetë. Një pjesë e ujit ju derdh përjashta duke i bërë viza në qafë e në gjoks, si

shiu që shket xhamave të dritares. Piu shumë, po ndjente ende etje.

— Po tani si do t'i vejë filli kësaj pune?
— pyeste veten me merak.

Ajo që e mundonte më tepër ishte ndjenja e thellë dhe e sigurtë se me nusen ishin sjellë keq, e kishin rënduar me fjalë, e kishin qërtuar pa të drejtë dhe më së fundi e kishin përzënë nga shtëpia si të huaj. Ishin përpjekur ta poshtëronin nusen, kurse tani poshtërimi e turpi rëndonin mbi shtëpinë e tyre e mbi atë vetë.

Dhoma që e heshtur. Një zjarr i paktë digjej në vatër. Thëngjihtë kishin vënë sipër një shtresë hiri të bardhë, si të ishin thinjur dhe urët, mbasi ishin djegur, dukej sikur qenë larguar nga njëra-tjetra e sikur s'i përkisnin të njëjtit zjarr. Ato shtriheshin mbi hirin e zjarrishtes dhe anës perustisë duke lëshuar një tym të hollë, secila më vete.

Tani edhe jeta e asaj shtëpie i përngjishte atij zjarri. Heshtje dhe qetësi. Miti shikon muret e dhomës, dyshtemenë, tymin e hollë të zjarrit, me dëshirë që të ngrihet e të bëjë diç-

ka, të merret me një punë, po ajo qetësi e shtyp dhe e mundon si një peshë e rëndë. Ngre sytë. Në trarët e nxirë të tavanit, mbi një shtresë kallamash, duket qemeri i kuq i një djepi. Ai djep s'ka për të zbritur më, kënga e tij s'do të dëgjohet natën në dysHEME dhe shpërgenjtë s'kanë për t'u lagur. Drurët e djepit do t'i brejë tenja.

Hidhërimi e pushtoi si ngërç dhe nga sytë i rrodhën lotë. Nuk donte ta ngushëllonte veten. Vuri kokën mbi duar dhe qau me një dëshpërim të sinqertë.

E ndjente veten si të larguar e të humbur, sikur është i ndarë nga njerëzit me një mur që s'ishte i zoti ta shikonte. Aty në dhomë provoi po atë ndjenjë që kishte provuar shumë vjet përpara dhe që e kishte harruar krejt. Atëhere qe i vogël, pesë-gjashtë vjeç, dhe i ishte lutur xhaxhait ta merrte në pyll, mbasi kishte qejf t'i hipte gomarit. Duke kërkuar luleshtrydhe nën dëllinja e mërsina, qe larguar, pa e vënë re, nga sheshi ku xhaxhai priste furka. I mbetur vetëm në mes të pyllit e pushtoi frika e çuditshme e vetëmisë dhe e braktisjes. Përreth

s'shikonte asgjë tjetër, veç murit të gjelbër prej drurësh dhe as e gjente dot shtegun nga i cili kishte ardhur. Pylli sikur ja fshihte të gjitha. I mbetur vetëm dhe i trembur filloi të thërriste me forcë. Pushoi vetëm atëhere kur pranë tij pa xhaxhain. U shtrëngua pas dorës së xhaxhait dhe të dy bashkë e gjetën fare lehtë sheshin ku kafshët po kullosnin të qeta.

Tani s'kishte si të thërriste.

Donte të dallonte se cila ndjenjë e bënte të vuante më shumë, sikur kjo të kishte rëndësi vendimtare. Përpiqej ta përdridhte atë fill mendimi nëse vuante ngaqë në shtëpinë e tij s'kishte për të pasur më gugatjë fëmijësh, apo nga padrejtësia që i patën bërë një pjesë-tari të familjes. Filli nuk shpërdridhej dhe të dy ndjenjat ishin pleksur keq me njëra-tjetrën.

Si duhet të veprohet?

Më vonë me ndjenjën e humbjes u pajtua dhe e pranoi, siç pranon njeriu gjërat e pashmangshme; kurse padrejtësia i rëndonte mbi gjoks. Ai donte të gjente një mënyrë që

të lehtësohej sadopak, dhe ishte gati të bënte gjithshka. Ishte gati t'i kërkonte ndjesë, t'i lutej, ta merrte sërish në shtëpi, sikur të ishte e mundur kjo gjë. Njëherë mendoi të blinte disa rroba fëmijësh e t'ja shpinte si dhuratë. Kjo do të ishte më shumë se t'i kërkonte falje, por pastaj hoqi dorë. Me kë do t'ja dërgonte ato rroba? Po t'ja dërgonte me ndonjë tjetër, do ta përqeshnin dhe do ta tallnin. T'ja shpinte vetë? Nuk guxonte. Nusja nga fyerjet që kishte pësuar, jo vetëm s'do t'i pranonte dhuratat, por mund t'ja përplaste edhe derën në fytyrë. Ky do të ishte shpërblimi që meritonte.

Dhe mbeti atje me dëshpërimin e tij.

KRUSHQ PA NUSE

Gotat e rakisë rrokulliseshin njëra pas tjetrës. Njëri nga dasmorët (nga të palës së nuses) ja mori këngës: «Në bash të qejfit të muhabetit». Me mendjen time gjykova se ky mik tregohej i nxituar që na u bëri veshëve këtë surprizë. Ajo këngë në vazhdim thoshte: «Na vjen kafja për me u pi» kurse ne, ashtu si e kishim zënë, donim nga një vinç secili dhe mezi të na shkulte prej rakisë. Megjithatë, disa të tjerë e pasuan këngëtarin qejfli, kurse ne, pjesa më e madhe, heshtnim, si të na kishte ardhur radha për të nusëruar. Faji nuk qe yni dhe asnjë fije përgjegjësie nuk

mbanim, sepse të tilla këngë janë të panjohura në krahinën tonë.

Ata që do të lexojnë këto rreshta, duhet të njihen me mua që po u rrëfej këtë histori. Quhem Besho Trebeshi. Jam nëpunës i gjendjes civile në lokalitet. Si njeri që merrem me gëzimet, lindjet, martesat etj. kam privilegjin që të jem i ftuar në çdo dasmë e gosti, që bëhet brenda kufive të lokalitetit tim. Besoj se nuk ka ndonjë shkelje këtu. Në fund të çdo ftese që më dërgohet, shënohet kështu: «Na nderoni me pjesëmarrjen tuaj në gëzimin tonë familjar». Dhe unë i kam aq mend sa të mos i bie së mirës me shqelma dhe tek e fundit, t'ua plotësoj qejfin me praninë time atyre që më nderojnë. Nuk më ka hije të veproj ndryshe, mua, ofiqarit të gjendjes civile, mua, dëshmitarit të çdo gëzimi në të gjithë lokalitetin.

Në dasmën që përmenda më parë, kisha shkuar krushk nga ana e dhëndrit në fshatin Kokërdhok. Nëntë krushq gjithsej dhe unë kryetari i tyre. Në shtëpinë e nuses na pritën si s'ka më mirë. Dhe për pak sa s'u mallën-

gjeva në çastin e arritjes te porta. Dolën gratë e filluan të këndonin:

«Ç'janë gjithë ata kalorës,
Beshua kryetar ndër ta,
në Kokërdhok se ç'i shpunë,
i pritnë me donoma».

E kam tipin kështu unë, prekem shpejt në të tilla raste. Shyqyr që nuk vazhduan më tej gratë e Kokërdhokut, se ndryshe do të më kishin parë duke nxjerrë shaminë për të fshirë hundët. «Po pse hundët e jo sytë», do të thoni ju?! Po kështu e kam unë, e thashë që jam tip më vete.

Kur hymë në odën e krushqve, pjatat e mbushura me meze dhe shishet e pijeve, që mbanin drejtqëndrim me grykëhapur, ma ngrohën zemrën dhe bënë që në mënyrë automatike ta ndjeja veten si veshka në mes të dhjavit.

Tani të mos e ngatërrojmë fillin e muhabetit e ta lidhim atje ku e këputëm. Hë, po, e kishim atje, tek ajo kënga që nuk i përket

krahinës sonë. Po u përzier të gjitha tani: edhe njerëzit, edhe zakonet, edhe muhabetet. Po shumë mirë u bë, s'ka përse të na mbetet qejfi. Ai që e mori atë këngë quhej Sefedin dhe, me sa mora vesh, kish gjezdisur në shumë kra-hina të vendit. Po, në fund të fundit, mirë bëri. Pa ç'ka se unë s'e ndiqja dot në atë këngë. Këngët vençe, me iso, i kam qejf unë.

— Hajde gëzuar, o shoku kryekrushk! — m'u drejtua me gotën plot i zoti i konakut! — Sa rrofsh, këto punofsh! E heqsh këmbën zvarrë, që të na i martosh të gjithë beqarët.

— Gëzim paç! — U zgjata që t'i përplasia gotat. — Për kështu të ardhçim ngahera!

U rrëkëllyen gotat dhe nga rakia, o burra, pirunjtë në mish. Pas kësaj mori udhë një muhabet i shtruar; ashtu pleqërisht.

Këtë muhabet e ndërpreu një djalë i ri, që filloi të këndonte:

«Të dielën që me saba!»

Ishte edhe ai nga pala e nuses. Po na e hidhnin ata të vendit me të kënduar. Por kë-

tij desha t'ja prisja këngën në mes e t'ja merrja ashtu si e kam zakon vetë. Ai po e prishte edhe melodinë. E merrte nxituar, si të merakosej mos i mbarohej pjata me meze. Ndërkaq këngëtari vazhdonte:

«Humbi Kostandineja»

Kjo nuk qe kënga që dija unë e që më bënte të kapërdisesha aq shumë kur ja thosha. Qe një këngë e re, nga melodia dhe përmbajtja.

«Bredhin fshati posht e la,
ç'u bë Kostandineja».

Ngjarja për të cilën bënte fjalë kjo këngë, pat ndodhur gati një muaj më parë, në një fshat tri-katër orë larg nga Kokërdhoku. Kostandinën e kishin fejuar e ëma dhe i ati me mblesëri. Vajza dhe djali qenë parë me njëri-tjetrin në klubin e lokalitetit. Kostandineja e vërejti me vëmendje të fejuarin; nga pamja ishte i mirë. Dhe nga anët e tjera ja kishin

lavdëruar. Siç kishin bërë shumë shoqe të saj, edhe ajo pranoi të fejohej. U lidh krushqia. Mirëpo më vonë vajzën e gudulisi dashuria në zemër. E zuri qymyri me nënkryetarin e kooperativës fqinjë. Prindërit e djalit diç morën vesh, u sëmboi dhe u ngutën për celebrimin. Kostandineja nuk e shihte të arësyeshme. Eh, bela or shok, kur vajza i del zot vetes. Jo, nuk ka ndonjë të keqe xhanëm, por bie fjala. Atëhere krushqit vendosën t'i martonin. Dhe u caktua e shenjta ditë e martesës. Vajza i kundërshtoi të atit. Ai si përgjegje i dha ultimatumin: «S'ka gëk, mëk!»

U bë dasma. Erdhën krushqit, hëngrën dhe pinë, kënduan e kërcyen gjithë darkën e së shtunës. Të djelën në mëngjez, kërko nuse, nuse hiç. Nusja qe bërë firare. . .

Këngëtari që kishte rrëmbyer me vete vëmendjen e të pranishmëve, e dridhte zërin dhe fjalët i lëshonte duke përdorur një notë ironie:

«Te pylli e panë ca gra,
u var Kostandineja».

Atë të diel fshati zjeu nga thashethemet.
Secili thoshte si ja priste mëndja:

«Te lumi e panë ca gra,
u mbyt Kostandineja».

Çibuku i të atit të Kostandines e nxirrte tymin parreshtur. E shtrëngonte kokën me duart e tij të mëdha plaku i ngratë, si ta kishte një kungull që donte t'i nxirrte farat e kalbura. I kishte zënë qelb të varfërit, por atëherë qe vonë.

Pamjen pak të vrejtur dhe disi ironike të këndonjësit e zëvendësoi buzëqeshja:

«Të hënë që me saba
u gjend Kostandineja».

Dasmorët u vunë të këndonin të gjithë së bashku me atë që ja merrte i pari. Harruan se detyra e tyre qe të bënë iso. Kjo i dha shkas atij që ta ngrinte më shumë zërin:

«Mori burrin me sevda,
nuse Kostandineja».

Gotat u përplasën me njëra-tjetrën. Pirunjtë u vërsulën mbi meze.

Të gjithë, së bashku me mezet, përtypnin edhe mendimet që la pas kënga e sapokënduar.

Kali, që krushqit e kishin marrë për të hipur në të Kostandinën, u kthye bosh. Hera e parë që shiheshin krushq të ktheheshin pa nuse. Me vete kishin pasur edhe dhëndrin, të cilin, siç më treguan, e kishin lidhur me litar në samar të mushkës, që të mos u ndodhte ndonjë aksident rrugës.

Tri ditë më pas Kostandineja së bashku me nënkryetarin e kooperativës fqinjë erdhi në zyrën time për të bërë celebrimin.

Fatmirësisht unë nuk u ndodha në atë dasmë. Shyqyr që pata një gosti tjetër te një kushëriri i gruas. Do të kishte qenë turp i padurueshëm që unë, dëshmitari i gëzimeve në gjithë lokalitetin, të isha pjesëtar i një grupi krushqish, që kthehen pa nuse.

U interesova të mësoja se kush që ai që këndoi këngën e Kostandines. Më thanë se ishte një shok i vajzës, i nuses që do të merrnim ne. Qenë njohur gjatë dy muajve në aksion, në hekurudhë.

Më dogji, se edhe kjo martesë bëhej me mblesëri, si ajo e Kostandinës. Mallëkova veten që kërkova një shpjegim të tillë. Gjumi im i asaj nate i ngjante atij të një lepuri të struktur në një ferrë, pasi e kanë ndjekur qentë gjithë ditën.

E nesërmja u gdhi një ditë e bukur, nga ato që vjeshta e dytë i dërgon rrallë e për mall. Por agimi i kësaj dite të bukur, kokave tona të trullosura nga pija, i dhuroi këtë lajm:
— Nusja ka ikur.

E kishte rrëmbyer ai djali që këndoi këngën e Kostandinës.

Ashtu maramendsh siç isha, kërkova të gjeja një vrimë ku të futja të paktën kokën, për të mos parë ç'bëhej përjashta.

Për fat nuk e kishim marrë dhëndrrin me vete, se kush i hynte mundimit për ta lidhur me litar pas samarit të mushkës.

Gjatë kthimit, vetëm një mendim më lehtësonte disi:

«Të paktën, nuk ishim ne të parët krushq, që ktheheshim pa nuse.»

TË MBETI DOLLIA, KRYETAR

Mbledhja e asamblesë së kooperativës po mbaronte. Shumica e anëtarëve nuk do të ishin lodhur më shumë sikur të punonin gjithë ditën në qilizmë, se sa atë ditë në mbledhje. Vetëm kryetari, edhe pse kishte dëgjuar mbi 50 diskutantë, dukej i freskët e gjithë gjallëri. Si ky kryetari ynë, o shokëni, besoj se rrallë takon. Gojën mjaltë, megjithëse kooperativa nuk ka asnjë koshere bletë. Ai të përshëndet i pari, bile 30 m para se t'i afroshesh ti. Të pyet për kalamajtë, interesohet për shëndetin e fëmijëve të lagjes. . . e për çfarë s'të pyet ky kryetari ynë! . . . Por vetëm nuk i ecën puna të ziut në kooperativë. Me një fjalë s'ka «fat».

Ja për shembull në mbledhjen e asamblesë e kritikuan se lopët nuk shkojnë mbarë në kooepativë dhe se shpendëve nuk u gjejnë as nishanin. A s'e kanë gabim ata shokë që kritikuan gojëmjaltin kryetar, se gjoja s'paska marrë masa për sigurimin e bazës ushqimore dhe të stallave e më the e të thashë? Po pse, more shokë, ç'punë ka kryetari me lopët. Kryetari është kryetar, dhe lopa mbetet lopë.

Po kryetari ynë di ç'bën. Ja, u ngrit të marrë fjalën. E shikoni si u buzëqesh të gjithëve, shikojeni, shikojeni! E pra nuk është gjynah nga zoti të kritikosh një alamet kryetari si ky? Sa i durueshëm. Ti i zbut kurrizin me kritika, ai të buzëqesh. Flisni tani a nuk do mëshiruar ky njeri pa «fat». Pritni sa u vendos qetësia, pastaj ja nisi:

— Të dashura motra, të dashur vëllezër! Jam shumë i prekur nga kjo mbledhje. Një lëmsh, si lëmshi i punëve të kooperativës sonë, më mbeti në grykë nga kritikata tuaja të dashura, të sigërtë dhe shumë e shumë parimore. Me shumë të drejtë mbi 50 e ca motra dhe vëllezër më kritikuan dhe unë i mirëpres

se, siç thotë populli ynë, ai që të qëرتون, edhe të do, ose le të shikojmë se ç'thotë një fjalë e vjetër egiptiane për. . .

— Bjeri shkurt, mor shoku kryetar; kemi hallin e lopëve, jo të egiptianëve. . .

Kryetari ktheu kokën nga personi që i preu llafin dhe i derdhi një sherbet buzëqeshjeje, saqë kooperativisti u ul i penduar. . .

— Aty do të vij, shokë, te lopa. — U mendua pak, pastaj nisi përsëri. — Lopa, motra dhe vëllezër, është bërë pak e çuditshme sot dhe shumë tekanjoze. Po marrim si shembull lopën foragjere. Në u japim kashtë gruri, ato s'e venë në gojë. Pse? Pa më thuaj ti, xha Trushi, para 20 vjetëve lopët që mbanim ne a e hanin kashtën e grurit? (Plaku pohoi me kokë). E pra, shokë më thoni, nuk mund t'i quajmë tekanjoze këto lopë, bile lopë me shumë kërkesa? E kam fjalën se ne duhet të dallojmë dhe të saktësojmë masën e fajit. Fajin që ka lopa i rruat, fajin, që kemi ne e ndajmë bashkë, sepse nuk është e udhës që të rëndojmë një ose dy persona. . . Ju, vëllezër dhe motra, me të drejtë kritikuat barinjtë, sepse

i lënë pa ujë. Ashtu është, bile plotësisht e vërtetë. Por s'u bë kiameti, vëllezër, se në fund të fundit nuk u bënë njerëz të shkretën. Ka pasur raste që ka mbetur edhe një brigadë pa ujë dhe asnjë nuk u ankua. Ju kritikuat barinjtë se kanë përdorur dajakun kundër lopëve. Edhe kjo e vërtetë është, shokë, megjithëse dajakun asnjë s'e do, por prapë ne, shokë, bëhemi nga gjaku. Dhe ai i shkretë gjak kur kalon temperaturën 37°, nuk e di se ç'bën. Unë mendoj se faji nuk qëndron plotësisht te barinjtë që kanë përdorur dajakun, por te lopët që thyejnë rregullat dhe disiplinën duke e bërë kështu dajakun me nyje. Këtu, shokë, unë nuk dua të mbroj barinjtë, sepse në fund të fundit ata i mbron. . . .

— Krushqia, shoku kryetar — ja preu fjalën një e re me shaminë e aksionit lidhur gushës. Kryetari s'e humbi toruan, megjithëse ajo që u tha që shumë e vërtetë (sepse dy barinjtë e lopëve qenë të dy kunetërit e kryetarit), por qeshi, bile me gjithë zemër:

— Po pse, moj motër, si thua ti, të mos bëjmë krushqi me njëri-tjetrin ne. . . ne jse, nej-

se... Je e re dhe aq kupton ti. (Këtë herë kryetari foli nëpër dhëmbë). Ju kritikuat kryesinë se nuk kanë siguruar bazën ushqimore dhe se lopët, duke qenë kockë e lëkurë, japin qumësht sa nuk ngopet një kalama. Ashtu është, motra e vëllezër. Kritikë me vend e me mend. Vetëm ne, shokë, duhet të gjejmë shkaqet e vërteta të gjendjes së lopëve. Pra unë mendoj se nuk është kryesorja baza ushqimore që lopëve u duken kockat si qeprat e stallave që kanë mbetur zbuluar, por merak, shokë, nepsi që kanë ato për jonxhë dhe hasëlle. Sepse, vëllezër, merak dhe nepsi bluajnë përbrenda jo vetëm lopët, por edhe njerëzit. Siç del nga sa thamë edhe në këtë çështje lopët ngarkohen me faj. . .

— O shoku kryetar! Më fal se të ndërpreva, por edhe unë jam dakord që lopët tona janë fajtores, prandaj unë propozoj që lopët t'i dënojmë si më poshtë vijon. . .

— Propozimin mbaje për në fund — e uli kryetari si me lezet dhe u hodh te shpendët.

— Tani, vëllezër e motra, do t'ju flas për shpendët. Shpendët janë një pasuri e madhe

për kooperativën. Në radhë të parë për mishin e tyre shumë të shijshëm, e dyta për puplat që mbushim jastëkët dhe ja këputim gjumit, e treta për vezët, e katërta për plehun dhe e fundit për këndezat që na zgjojnë herët, që të mos mbetemi në gjumë deri në orën dhjetë. Dikush nga ju tha se shpendët nuk rriten në kooperativën tonë. S'është e vërtetë, motra e vëllezër. Pa më pyesni mua? Unë po ju them vetëm një fakt. Mbrëmë isha për darkë te shoku Hasan Laneti dhe kemi ngrënë një kaposh deti sa një dash. Çfarë shije, lëre, ore, lëre. Apo nuk shkonte me verën 7 vjeçe? Apo s'e kishte rritur vetë shoku Hasan?

— Këtë vit rrita 30 krerë në pronën time, — u lëvdua Hasani nga presidiumi.

— E, shokë, si thoni? Këtu nuk ju dhashë një rast të veçuar, sepse unë nuk kam ngrënë kaposh vetëm te Hasani, por edhe te Kapllani, te Lumani, te Stefani, Selmani. . .

— Si sulltani e paske mbajtur veten, o shoku kryetar, — rimoi një nga diletantët e estradës së kooperativës. Kryetari bëri sikur

nuk e dëgjoj, megjithëse asamblenë e mbuluan të qeshurat.

Kryetari qëndronte në këmbë duke mos ditur në se duhej të ulej apo të vazhdonte. Nga kjo përfitoi kooperativisti, që desh të bënte propozimin e dënimit të lopëve.

— Me leje, besoj se mbaruat, shoku kryetar?

— Po — mezi munda të përgjegjej kryetari dhe u ul. Fjalën e mori kooperativisti.

— Shokë, unë ja mbështet fjalën kryetarit tonë. Dhe ashtu siç thashë, fajin më të madh e kanë lopët, prandaj propozoj që për shoqet lopë të marrim këto masa:

E para — Që t'u «vritet» barku lopëve, propozoj të dyfishojmë sipërfaqen e mbjellë me jonxhë.

E dyta — T'i heqim nga kasollet e vjetra e t'i çojmë në stallat e reja. Kështu, shokë, mendoj se do t'i bëjmë që të digjen nga malli për vendlindjen (kasollen e vjetër).

E treta dhe e fundit — Meqenëse lopët tona kanë kërkesa për shumë gjëra, propozoj që t'u hiqet dajaku nga kurrizi si stoli e te-

përt dhe t'u jepet shokëve tanë barinj si shpërbllim i punës së tyre «shumë të ndërgjegjshme».

Si përfundim i propozoj asamblesë që të mendojë të diskutojë e të vendosë se kush e ka bërë hallall një dajak të mirë nga shokët e kryesisë.

— Të mbeti dollia, kryetar, — foli vajza me shaminë e aksionit.

Kryetari u mblodh grusht. . .

PËRMBAJTJA

	Faqe
1) Aleks Luarasi — Goricarët	7
2) Mato Gjini — Një ditë dhe një natë	32
3) Xhafer Matuka — Buka	47
4) Ilenden Spasse — Një lapidar pranë pira- midës	60
5) Dritëro Agolli — Kamarja	72
6) Petro Marko — Dy portrete të një fytyre	86
7) Dhimitër Xhuvani — Një natë pa dritë	98
8) Naum Prifti — Nusja e shtëpisë	108
9) Dylber Hasani — Krushq pa nuse	125
10) Ndini Bardhi — Të mbeti dollia, kryetar	134

Tirazhi: 8000 kopje Formati: 70 x 100/32 Stash: 2204-65

**Shtypur në NISH Shtypshkronjave «Mihal Duri» —
Tiranë, 1972**